# GAZETA SHQIPTARE




Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com

Viti XXIV - Nr. 7470 E premte 16 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)




Opinioni i Ditës

Nga SULEJMAN MATO

## Teatër i ri, një zgjidhje që i kënaq të gjithë…



Teatër i ri? Pse jo? Madje shumë teatro të rinj. Tiranës së një milion banorëve i duhen së paku 20 teatro të rinj, në qoftë se ne e duam seriozisht artin ... Vijon në faqen 18



Dje në "Deutsche Welle"

Nga KERSTEN KNIPP

## 7 vite luftë në Siri dhe gabimet e perëndimit

Lufta në Siri është një rast për lëndën e historisë fiktive - çfarë do të ndodhte sikur? Por më shumë kjo çështje shtrohet po t'u referohesh shteteve ... Vijon në faqen 19

INTERVISTA, FLET EKSPERTI: FORMULA BAZE DHE KOEFICIENTET PARA E PAS 1994

# GOCI: SI TE LLOGARISNI PENSIONET E PLEQERISE

"Shembuj konkretë si të bëni vlerësimin e masës që do të përfitoni. Kriteret dhe dokumentacioni, çfarë duhet të bëni kur humb libreza e punës"





(Në foto) Eksperti i pensioneve, Sabah Goci. Pensionistë (foto ilustruese)

Në faqet 10-11



Batutat e kryeministrit me Spahon e reagimet

## Përplasja për familjet e varfra, Edi Rama: Lot krokodili. Basha: Përballu me krimin tënd

Financimi rus për PD, Balla nxjerr kontratën me "Muzin", Majko: Po e teprojmë

Nga VALENTINA MADANI

Kreu i opozitës, Lulzim Basha i kërkoi dje në Kuvend kryeministrit të kthejë urgjent në skemën ekonomike, 30 mijë familjet që ka hequr prej saj. Por z.Rama vendosi kufje në vesh, duke e injoruar atë që kishte për të thënë Basha ...

Në faqet 2-3

VIZITA

### Meta merr me vete në Baku ish-presidentët, me të edhe Berisha, mungojnë Topi e Moisiu

Në faqen 5

DETAJET E REJA

### Helmoi vjehrrën, flet i shoqi: Marjanën e përzura nga shtëpia 5 muaj para vrasjes

Në faqen 7

SI U ZBULUAN

### 2.3 tonë drogë me skafe drejt Italisë, 21 shqiptarët e arrestuar nga grupet Durrës e Vlorë

Në faqen 8

ÇESHTJA NE 'VENECIA'

### Shqipja zyrtare në Maqedoni, Ivanov refuzon dekretimin. VMRO padit Xhaferrin

Në faqen 22

PJESA E DYTE



### ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen dhe lista me 4900 veta

Në faqet 14-17

Do të nisë verifikimi për rreth 30 mijë parcela, nuk preken fermerët

## Pezullimi i tapive me '7501'-shin, Lame: Preket edhe bregdeti

*Shoqata e pronarëve kundër, Vorbsi: S'mund të hiqet pronësia*

Nga ORNELA MANJANI



Të gjitha pronat që janë 1.5 kilometër nga deti, janë vendosur nën hetim prej një task-force të posaçme të ngritur me urdhër të kryeministrit në shkurt të këtij viti. Janë në total rreth 30 mijë parcela toke, të cilat do të verifikohen të gjitha në të gjithë vijën bregdetare të vendit. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame dje gjatë një prononcimi për mediat, ku bën të ditur se subjekt i verifikimeve do të jenë ...

Në faqen 6

KUVENDI
DEBATI

Humor në parlament, ironia me kryeministrin për skenarin e financimit Rusi-PD

# Balla nxjerr kontratën e PD me "Muzin", Majko: Po e teprojmë

## Ministri, PD-së: Për rusët na pyesni ne, i njohim më mirë

Valentina Madani

Kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla publikoi dje kontratën e firmosur nga Lulzim Basha me kompaninë "Muzin Capitol", e cila është pajtuar nga skocezja me pronarë rusë, "Binniata Trade", për të lobuar në Departamentin Amerikan të Shtetit për interesa të PD. Sipas Ballës, kanë qenë biznesmenë rusë, të cilët kanë paguar për PD-në në Uashington. "Ç'ke bërë ti me ndihmën ekonomike ruse, Lulzim? Kush kanë qenë këta shqiptaro-amerikanë fantazmë që paskan mbledhur për ty 1 mln USD, për një kryedembel, për të baltosur Shqipërinë. Nuk bëhen 100 shqiptarë që të mblidhen për të sharë Shqipërinë, nuk e bëjnë shqiptarët këtë. Kontratë e Lulzim Bashës me 'Muzin Capitol' dhe PD-së, qëllimi kryesor elektoral. Kjo është domosdoshmëri, detyrim ligjor që të ishte depozituar në KQZ. Sepse për shkak se qëllimi i saj është elektoral dhe thuhet që në fillim të saj për të dizenjuar misionin elektoral tëndin, duhet ta kishte çuar në KQZ. Pse nuk e ke çuar? Kjo çështje sapo ka filluar të zbardhet. Pronarët e kompanisë së lobimit, 'Binniata Trade' janë tre shtetas rusë", u shpreh Balla. Por ministri për Diasporën, Pandeli Majko e quan të tepruar sulmin e të vetëve ndaj PD-së dhe kreut Lulzim Basha. Madje, Majko e ktheu në batuta dje çështjen e financimeve ruse të dyshuara të përfituara nga PD-ja. Ndonëse e nisi fjalën e tij në seancën e djeshme plenare me çështjen e ndihmës ekonomike, Majko e mbylli pikërisht me debatin për financimin rus. Majko përmendi se partia e tij e vjetër ka eksperiencë me rusët, ndaj u sugjeroi PD-së të pranojë një këshillë. Jo vetëm sepse ministri e konsideroi Partinë Komuniste si "partia jonë", por edhe se shkoi pas në kohë për t'u thënë demokratëve se për rusët duhej të konsultoheshin më parë me Partinë Socialiste. Majko pranoi se akuzat për financim rus të PD-së janë një teprim dhe se nuk ishte dakord me ato që kishte thënë Taulant Balla në parlament. Me humor, Majko trajtoi të gjithë skenarin që është ngritur nga kryeministri Edi Rama dhe nga një seri konferencash nga selia e PS-së. "Edhe ne ndonjëherë e teprojmë me këtë punën e ndihmave ruse apo sponsorizimit rus për Partinë Demokratike, të jemi të sinqertë. Nuk jam dakord me kolegun Balla në disa drejtime. Ne si partia jonë nga viti '49 deri në '61 e kemi pasur… partia e vjetër është fjala. (shpërthejnë të qeshurat në parlament). Nga '49 deri në '61 edhe partia e vjetër e majtë pati një afeksion, por e pati afeksionin për ideologji, jo për para. Me thënë të drejtën, na duket shumë interesant ky eksperimenti që merrni para nga rusët për të bërë lobizëm në Amerikë, shumë interesant është. Por, kur vjen puna te rusët duhet të konsultoheni me ne, se ne kemi eksperiencë në këtë punë. Ne e mbyllëm këtë punë në '60 dhe bëmë edhe një film, 'Ballë për ballë', por ju do e mbyllni me ndonjë këngë të tipit 'Lule ti e lule unë, dil këtej se kam pak punë'", tha Majko ndërsa demokratët kanë qeshur, kurse Taulant Balla bërtiste: "Dëgjojeni deri në fund, dëgjojeni…".





**LULZIM BASHA**
Kryeministri Rama heshti dje në parlament për kontratat e lobimit të PD, ndërsa kreu i opozitës, Basha e kaloi me një fjali këtë çështje, duke i kërkuar mazhorancës të mos merret me përralla ruse, por të shikojë faktet me drogë kolumbiane.

**ERION BRAÇE**
Erjon Braçe foli dje për një drejtësi të munguar për 26 viktimat që humbën jetën nga shpërthimet e 10 viteve më pare në Gërdec. Ai kërkoi që në fillim të fjalimit një minutë heshtje. Braçe u ndal te fajtorët e pandëshkuar të kësaj tragjedie, teksa përmendi sërish emrin e kreut të opozitës.

### Bylykbashi: Rama s'do t'ia dijë për ambasadorë sa kohë kap pushtetin

Deputeti i PD-së, Oerd Bylykbashi, i bëri dje thirrje mazhorancës që të miratojë amendamentin kushtetues të paraqitur nga opozita dhe të rikthejë në rrugën e kushtetutshmërisë zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm. Ai tha në Kuvend se dhe sikur të gjithë ambasadorët të mbushin lozhat, Edi Rama nuk do t'ia dijë sa kohë kap pushtetin. "E miratojmë, ndalim uzurpimin dhe kthejmë kushtetutshmërinë në zyrën e prokurorit. Kandidatët do të renditen sipas aftësisë dhe propozohen jo nga politika, por nga Gjykata Kushtetuese. Kandidatët do t'i nënshtrohen vetingut me prioritet dhe afat të shkurtër. Dhe në fund, Prokurorin e Përgjithshëm do e votojë parlamenti me 3/5 e votave, siç thotë Kushtetuta", tha deputeti i PD. Bylykbashi paralajmëroi: "Këto institucione që po kapni do të shkërmoqen, sepse tërmeti politik që shkakton shkelja e konsensusit të 22 korrikut do t'i zhbëjë. Nxirrni sa të doni OJF me tenda apo ç'të doni. Ashtu siç u zhbë kapja e 1998-2000. Do marrë kohë kjo zhbërje, por tolerancë për ju dhe për ata që ju ndihmuan duke u betuar me çadër nuk ka për të pasur! Tani kërkojini 'Mami Johns'-it të shkruajë ndonjë artikull me paratë e 'Dajë George' kundër ndryshimeve kushtetuese!".



### Salianji: Funksionarët e PS marrin ndihmë ekonomike

Deputeti i PD-së denoncoi dje disa raste të tjetërsimit të ndihmës ekonomike. Sipas tij, në qarkun e Korçës po marrin ndihmë ekonomike disa funksionarë të PS-së. Përmes fotove Salianji tregoi se si ka funksionuar kjo skemë."Skema tërësisht abuzive, përdoret për blerje vote dhe kërcënim. Një nga format e korrupsionit elektoral. Që të mos jete abuzive publikoni kriteret e skemës, pikavarazhin konkret dhe pse e avantazhohet qytetari x dhe jo qytetari y. Ky kontingjent në masën më të madhe janë votues të PS, ne po kërkojmë që shteti të marrë përsipër detyrimin e vet, jo t'i trajtojë për mëshirë dhe as të tallemi siç bëni ju. Ja ku i keni emrat e sekretarëve dhe komisionerëve të PS-së me vila, që përfitojnë dhe qytetarë në mjerim që i keni hedhur në mëshirën e Perëndisë. Që të luftoni dembelizmin mos jepni para kot, që të kuptojnë vlerën e parasë rrisni pagesën dhe futini në punë komunitare. Ndihma të mos jetë lëmoshë, por pagesë dinjiteti, që kushdo të ketë mundësi të jetojë", tha Salianji.



### Shehi: Fukarenjtë hanë kos për darkë, Rama hartën e Shqipëri për ta grabitur

Deputeti i PD-së, Dashamir Shehi deklaroi dje në Kuvend se fukarenjtë në darkë vënë përpara tasin e kosit, duke shtuar se qeveritarët vënë përpara hartën e Shqipërisë për ta bërë kulla. Ai shpjegoi me fakte pse ka dhe do të ketë varfëri në Shqipëri, duke marrë shembull një pamje të trishtë nga Elbasani: "A vijnë më shumë se njëmijë lekë a dymijë lekë nga ballokumet?! Kjo është varfëria! Atë të shihte kryeministri në Elbasan! Të mos fillojë të tregojë përralla të kota, sepse ky grup njerëzish që qeveris sot, mendon se të varfrit janë të pazotë dhe këta janë 'gjenitë e Shqipërisë', që mund të bëjnë miliona. Të gjithë janë drejtuar drejt parave! Fukarenjtë e Shqipërisë, është një batutë që nuk kisha qejf ta thosha, në darkë venë sofrabezin dhe atë pjatën e supës e tasin e kosit. Këta zotërinjtë këtu, ky i pari, venë hartën e Shqipërisë për darkë. Dhe vënë gishtin: ka tepruar edhe kjo tokë këtu, ka tepruar edhe kjo, ta bëjmë kullë! Këta, fukarenjtë venë sofrabezin të hanë fukarallëkun e vet për darkë, këta venë hartën e Shqipërisë për të ngrënë nga një copë Shqipërie përnatë. Ndaj ka varfëri këtu!", tha z.Shehi.

REDAKSIA: **Redaktor i Suplementeve dhe Sociales:** Rezarta Delisula, **Redaktor i Rretheve:** Trëndafile VISHA, **Redaktor i Kulturës:** Fatmira Nikolli, ***Art Designer:*** Nevila SAMARXHI,
ADMINISTRATA**: Përgjegjëse e Financës:** Alma Smokthina 0682074397, **Shpërndarja:** Elvis Llaka Cel 0682074416**, *Marketingu*:** Cel:0682074415***-email:marketing@gazetashqiptare.com*, ADRESA**: Ish-Drejtoria e Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116, ***Marketingu*:** Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, **Internet**: www.gsh.al, **Email**: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, **SHTYPUR në "Klasik"Shpk**

Përplasja për familjet e varfra, kryeministri me kufje në vesh në parlament

# Mocioni, Rama: Lot krokodili Basha: Përballu me krimin tënd

## *Të përjashtuarit, përballja me emra konkretë*

Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha i kërkoi dje në Kuvend kryeministrit të kthejë urgjent në skemën ekonomike, 30 mijë familjet që ka hequr prej saj. Por z.Rama vendosi kufje në vesh, duke e injoruar atë që kishte për të thënë Basha për skemën e ndihmës ekonomike. Basha i kërkoi kundërshtarit të tij të heqë kufjet. "Hiq kufjet, ato që vendos në parlament dhe ato të tjerat që i kanë bllokuar veshët dhe sytë për të parë Shqipërinë e vërtetë! T'u rikthejë ndihmën ekonomike njerëzve në nevojë, të ndalë gënjeshtrën se mund t'i ndihmojë me 6% të bashkisë", tha Basha. Gjatë seancës maratonë për skemën e ndihmës ekonomike, kryeministri Rama tha se PD kundërshton reformën që vetë ajo e ka bërë, ndërsa z.Basha i tha të përballet me krimin e tij. "Këta që kërkojnë sot llogari për ndihmën ekonomike, i jepnin vetes ndihmën ekonomike. Lotët e krokodilëve që derdhen përditë në mungesë të ideve, programit, lidershipit të një opozite që nuk di ku ka kokën e jo më t'u gjejë rrugën atyre që kërkojnë rrugë për të ardhmen, pengojnë që të shikohet një gjë që duhet përsëritur", theksoi Rama. Kreu i opozitës, Basha pranoi që skema e ndihmës ekonomike mban firmën e PD-së, por sipas tij, kjo qeveri mban të fshehur formulën e pikëzimit dhe kjo ndodh me urdhër të kryeministrit. "Ti refuzon të shkosh dhe të shikosh se si ushqehen që në mëngjes me qepë e me lakra turshi. Reforma e nisur në vitin 2012 është marrë peng nga synimi yt për t'i përdorur të varfrit si mish për top. Banka Botërore, mbështetëse e kësaj reforme, vetëm një javë më parë deklaroi se 70 për qind e familjeve më të varfra në Shqipëri janë përjashtuar nga ndihma ekonomike", theksoi z.Basha. Kreu i PD solli emra konkretë familjarësh të përjashtuar, sipas tij, pa të drejtë nga ndihma ekonomike. "Ti je mbështetësi më i madh i dembelizmit dhe klientelizmit në Shqipëri. Ka bërë kontrata për miqtë e tij, ka dhënë miliona për miqtë e tij pa punuar fare, ndërsa të varfrit i merr shpirtin dhe i quan shqiptarët dembelë. Ekonomia është përqendruar në pak duar. E dimë që Rama nuk merr vesh nga ekonomia, ka edhe një ministër injorant për ekonominë. Nuk merret me ekonomi vetëm me fasada e përralla", - tha Basha. "Kjo është vajza e parë. Qante sepse nëna donte të vriste veten". Por Rama iu kundërpërgjigj: "Në njësinë administrative, Lulzim, ke takuar zj.Burbuqe dhe të lajmëroj se zj.Burbuqe është përfshirë në skemën e ndihmës". Kryeministri pranoi se janë më shumë se 20 mijë familje që janë nxjerrë nga skema e ndihmës ekonomike.



**VERIFIKIMI**

Kryeministri Rama përmendi dje në Kuvend të gjitha familjet që janë vizituar nga kreu i opozitës. Sipas Ramës, të gjitha këto familje ose janë përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, ose ato nuk plotësojnë kriteret, pasi nuk kanë deklaruar të ardhurat.

**REFORMA**

**ARBEN AHMETAJ**

"Situata e opozitës është ditë e zezë. Nuk ka kauzë. Është shumë e rëndësishme t'u kthehemi disa shifrave që kanë të bëjnë me ndihmën ekonomike. Është reformë, patjetër. Po pse është reformë? Sepse në finale, kur diskutojmë për të varfrit, nuk e mendojmë dhe nuk duhet ta mendojmë ndihmën ekonomike si shpëtim. Ndihma ekonomike është një moment kalimtar", - tha z.Ahmetaj.

**AKUZAT**

**ORIOLA PAMPURI**

Deputetja e PD, Oriola Pampuri u bëri dje thirrje të gjithë atyre që janë përjashtuar nga skema e ndihmës të vijnë e të protestojnë para parlamentit shqiptar, në mënyrë që të takojnë edhe kreun e qeverisë dhe të mund të zgjidhin hallin e tyre. Ajo bëri publike një foto sipas së cilës paraqet një realitet migjenian me të cilin jemi përballur në takimet me njerëzit.

**SKEMA**

**OGERTA MANASTIRLIU**

Ministrja e Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu deklaroi se skema e re e ndihmës ekonomike u ka dhënë mundësinë mbi 10 mijë familjeve të reja, që me skemën e vjetër përjashtoheshin për kritere absurde, të përfitojnë për herë të parë ndihmë ekonomike në janar 2018. Sipas saj, sistemi elektronik nuk lejon më abuzimet me fondet e ndihmës ekonomike.

**BATUTAT, RAMA: PROFESOR, S'VJEN NGA PYLLI! SPAHO: KRYEMINISTËR ME POTURE TË MBUSHURA**

**Edmond Spaho:** Personi që duhet të na japë përgjigjet dhe që është kryeministri nuk është në sallë. Ndërprisni seancën të vijë kryeministri këtu dhe pastaj vazhdojmë sipas rregullave.

**Gramoz Ruçi:** Kryeministri do të vijë, pasi është në një takim me ministren e Jashtme të Kroacisë. Seanca do të nisë kur të mbërrijë kreu i qeverisë.

(Kryeministri hyn në sallë dhe vendos kufjet në vesh"

**Edmond Spaho:** Kryeministri të heqë kufjet. Nuk jemi këtu për të dëgjuar muzikë.

Gramoz Ruçi Kufjet janë për t'ju dëgjuar më mirë juve.

**Edi Rama, Spahos:** Ta kam thënë edhe herën e shkuar. Ia thashë edhe Lulzimit që ta kishte parasysh, por nuk më dëgjoi, sepse Lulzimi kur shkon tek të varfrit, shkon për t'i përdorur për të dalë në fotografi dhe nuk e ka mendjen si të ndihmojë të varfrit, por e ka mendjen si të gjejë ndihma nga të tjerët që të dalë në fotografi me të pasurit që ka 6% fond për pushtetin vendor.

Është një 6 %-sh, i cili shkon ekzaktësisht për ata në nevojë, që pushteti vendor gjykon se duhen mbështetur me asistencë. Dëgjojeni sa interesant: Me ligjin e 2011-s këta vunë 3% për këtë çështje që do të përdorej nga bashkitë me demek….

**Edmond Spaho:** 3% e pushtetit vendor të bashkisë.

**Edi Rama:** Profesor, të të japë kufjet që unë të vazhdoj, ti të dëgjosh çfarë dëgjoj unë? Të lutem! Mbaj kufjet e mia, dëgjo atë që dëgjoj unë, që unë të flas. Të lutem!

**Edmond Spaho:** Kjo ka bërë që dëgjon gabim, prandaj…

**Edi Rama:** Profesor të lutem, mos u bë si ata nxënësit që të ndërpresin. Je profesor, vjen nga katedra, nuk vjen nga pylli.

**Edmond Spaho:** Dakord, ta kthej në replikë përgjigjen.

**Edi Rama:** Po patjetër, kur të mbaroj, hajde fol këtu, por jo i pyllit. Je i katedrës. Ata të pyllit le të flasin.

**Edmond Spaho:** Dakord!

**Spaho në replikë:** Dy çështjeve kryesore u bëre bisht. Ke zvogëluar me 38% numrin e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe ke zvogëluar me 40% fondet. Por do ta marrësh përgjigjen nga kolegët e mi në diskutimet e tyre. Ti Edi merresh me individin, nuk merresh me problemin. Unë nuk merrem me individin, se po të merresha me individin, do thosha që "kryeministri ynë është me poture si Haxhi Qamili tek romani 'Vit i Mbrapshtë' dhe shpeshherë i mbush ato poture. Ose do të thosha që "ti vesh çorape jeshile, çorape të verdha", ose do merresha me atletet e tua, që i shkove zv.presidentit amerikan dhe pastaj të përzunë. Por këtë nuk e bëj. Pse nuk e bëj? Për një arsye, se ti problemin nuk e ke tek këmbët, ti problemin e ke tek koka, koka s'rregullohet.



**TRITAN SHEHU**

"Më thanë pse e kam krahasuar Gjirokastrën me Alepon? Unë kam thënë se kështu siç e keni nisur me Gjirokastrën, do ta shndërroheni si Alepon që është e shkatërruar sot. Në Gjirokastër mungon infrastruktura, mungojnë investimet. Atje po rritet varfëria çdo ditë dhe ka një mungesë shprese, e cila skeme është futur me qëllim për të shkatërruar shpirtin e atyre banorëve", tha deputeti i PD.

"Lëmoshë për të blerë më lehtë zgjedhjet"

## Ndihma ekonomike, Kryemadhi: Të varfërve t'u jepen 240 dollarë në muaj

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi prezantoi dje skemën e forcës së saj politike, sesi mund të dalin nga varfëria familjet shqiptare. Ajo deklaroi se kjo realizohet duke çuar fondin e ndihmës ekonomike 2% të GDP, çka do të thotë që mbi 80 mijë familjeve do t'u jepen 240 dollarë në muaj nga qeveria. Kryemadhi qortoi skemën e re të qeverisë për ndihmën ekonomike dhe tha se qëllimi i kësaj skeme është që të ruajë shqiptarët të varfër. "Sepse sa më të varfër të jenë shqiptarët, aq më lehtë blihen në zgjedhjet e ardhshme. Ne duhet të përqafojmë idenë se çdo qytetari shqiptar duhet t'i garantohet ajo që në konceptet moderne ekonomike dhe të mbështetjes sociale quhet të ardhurat bazike universale. Konkretisht - shtoi ajo - ne besojmë se mund t'i japim fund varfërisë absolute për çdo shqiptar vetëm nëse fondi i ndihmës ekonomike do të shkojë 2% të GDP. Kjo do të thotë që mbi 80 mijë familjeve me mesatarisht 4 anëtarë do t'u jepet nga qeveria 240 dollarë në muaj për çdo familje, pra 2 dollarë në ditë për çdo anëtar të saj, në mënyrë për të kaluar pragun e varfërisë absolute. Përmes kësaj skeme, mbi 300 mijë të varfër do të dilnin nga varfëria absolute në të cilën ndodhen aktualisht. Për ne kjo është financiarisht e mundur dhe realisht si objektiv i realizueshëm. Mjafton të kursejmë dy koncesione abuzive të shëndetësisë dhe kjo skemë do të jetë efikase", tha zj.Kryemadhi.



## SITUATA POLITIKE
### REAGIMET

Ministri i Jashtëm pret homologen kroate: KE t'i qëndrojë besnik rekomandimit të 2016-ës

# Autorizimi nga Meta për detin, Ditmir Bushati: Jemi afër momentit

## "Së shpejti Greqia do njohë lejet e drejtimit të makinave"

Darina Tanushi

Ministri për Evropën e Punët e Jashtme, Ditmir Bushati deklaroi dje, se në ditët në vijim nga Greqia do të vijë një tjetër lajm pozitiv për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit të automjeteve. Gjatë një konference të përbashkët me zv. kryeministren dhe ministren e Punëve të Jashtme të Republikës së Kroacisë, znj. Marija Pejcinovic Buric, Bushati deklaroi se ka kohë që po punohet për një vizitë në nivelin e kryeministrit grek në Shqipëri, por ende nuk ka një datë apo afat të finalizuar për këtë gjë. "Vizita është e rëndësishme në vetvete, sepse presim që përmes kësaj vizite të shënohet një hap i ri pozitiv në marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe Greqisë, por nga ana tjetër, puna e përbashkët po vazhdon", tha Bushati në përgjigje të gazetarëve. "Në nivelin e ekspertëve po punohet për të jetësuar të gjithë paketën e çështjeve, për të cilat palët kanë rënë dakord që do të duhet të bisedohet dhe natyrisht, përsa i përket fillimit të bisedimeve për një marrëveshje të re për delimitimin e zonave detare, e kam fjalën këtu për detin territorial, për zonën ekskluzive ekonomike dhe shelfin ekomomik, ne jemi në kontakt të vazhdueshme me Presidentin e Republikës. Siç e dini, Presidenti i Republikës ka kërkuar informacion për çështje specifike, të cilat shkojnë në disa raste edhe përtej fokusit dhe kompetencës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kemi kryer gjithë procesin e koordinimit edhe me institucionet e tjera dhe i kemi dorëzuar presidentit gjithë informacionet që ai ka kërkuar", sqaroi ministri. "Besoj që jemi afër momentit kur ekipi shqiptar të ulët në tryezë më ekipin grek me shpresën se do të arrijmë një marrëveshje të re në këtë fushë, e cila besojmë se do të jetë një marrëveshje më e mirë, nuk diskutohet se ajo e 2009-ës, më e drejtë, me e ndershme dhe në fund të ditës, një marrëveshje që do të çlirojë energji pozitive në marrëdhëniet midis dy vendeve tona", tha Bushati. Sa i përket integrimit në BE dhe çeljes së negociatave, Bushati mori edhe mbështetjen e zv.kryeministres kroate, e cila tha: "Sigurisht që Kroacia do ta mbështesë nëpërmjet mbështetjeve të ndryshme, pikërisht Shqipërinë, pra nisjen e negociatave për Shqipërinë. Sigurisht që është në dorë të komisionit që ta lëshojë këtë dokument muajin që vjen. Shpresojmë që komisioni do t'i konsiderojë përpjekjet e qeverisë shqiptare. Janë shumë përpjekje të mëdha". Nga ana e tij, ministri Bushati u shpreh: "Besoj se duhet të jemi të gjithë të qartë që ne nuk presim dhurata dhe as që bëhet fjalë për lëshime reciproke. Ne presim që në radhë të parë Komisioni Evropian dhe më pas vendet anëtare, t'i qëndrojnë besnik rekomandimit të 2016-së dhe logjikës së miratuar nga të gjithë vendet anëtare të Bashkimit Evropian ku parashikohet fillimi i bisedimeve për anëtarësim i lidhur me procesin e vetingut apo zbatimit të reformës në drejtësi".



**REFORMA NË DREJTËSI**

"Ka disa dorëheqje të niveleve më të larta, qoftë të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe Prokurorisë së Përgjithshme, që tregon që vetingu dhe procesi i vetingut i ka dhënë efektet e veta në praktikë dhe besojmë fuqishëm që duke u nisur nga këto reforma, Komisioni Evropian do të vijë me një rekomandim përsa i përket nisjes së bisedimeve për anëtarësim", tha dje Bushati.




## Ruçi pret zv.kryeministren kroate: Reforma në drejtësi po jep frytet e para

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi priti dje, në një takim zv.kryeministren dhe ministren për Çështjet e Jashtme dhe Europiane të Kroacisë, Marija Pejcinovic Buric, ku u vlerësuan arritjet e Shqipërisë në përmbushjen e rekomandimeve të KE-së. Gjatë bashkëbisedimit, Ruçi dhe Pejcinovic Buric ndanë mendime të njëjta për rëndësinë e vijimit të shkëmbimit të përvojave mes palëve, si në kuadër të bashkëpunimit parlamentar, ashtu dhe nëpërmjet institucioneve të tjera shtetërore, me qëllim përfitimin nga eksperienca e suksesshme kroate në procesin e integrimit të vendit në Bashkimin Europian. Kryetari i Kuvendit vuri në dukje përpjekjet serioze të shtetit shqiptar për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Europian për Shqipërinë në rrugën e anëtarësimit në BE dhe theksoi se miratimi dhe fillimi i zbatimit të Reformës në Sistemin e Drejtësisë po jep frytet e para pozitive. Nga ana e saj, Marija Pejcinovic Buric, duke vlerësuar arritjet pozitive të Shqipërisë në përmbushjen e rekomandimeve të KE-së, e veçanërisht sa i takon Reformës në Sistemin e Drejtësisë, shprehu mbështetjen e plotë të Kroacisë për vendin tonë në procesin e integrimit në BE.



PD do të verifikojë pasojat e vonesës së Kuvendit për imunitetin e ish-ministrit

## Komisioni hetimor për "Tahirin", PS me 6 anëtarë në komision

Partia Socialiste ka zbardhur dje emrat e deputetëve që do të jenë pjesë e komisionit hetimor për çështjen "Tahiri", kërkuar nga Partia Demokratike. Deputetët Ermonela Felaj, Klotilda Ferhati, Pjerin Ndreu, Paulin Stërkaj, Xhemal Qefalia dhe Bashkim Fino do të jenë pjesë e këtij komisioni prej 11 anëtarësh që do të drejtohet nga opozita.



Ndërkohë PD do të ketë katër anëtarë, përfshirë kryetarin e Komisionit Edi Paloka, përkatësisht deputetët Enkelejd Alibeaj, Myslym Murrizi dhe Flamur Noka. LSI do të përfaqësohet me një anëtar, deputetin Endrit Braimllari. Më 6 mars, mazhoranca dhe opozita miratuan me 121 vota pro dhe asnjë kundër ngritjen e komisionit hetimor për çështjen "Tahiri". Objekti i punës së tij do të jetë verifikimi i pasojave të vendimit të parlamentit për të mos lejuar arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm të akuzuar për përfshirjen në trafikun e drogës. Një tjetër objekt do të jetë dhe verifikimi i rolit të Ministrisë së Drejtësisë në ekstradimin në Itali të Nazer Seitit, i akuzuar dhe si financier i grupit "Habilaj" të arrestuar në Itali. Opozita akuzon se me këto veprime, si Kuvendi ashtu edhe ministria kanë ndikuar në procesin hetimor. Ky komision mund të nisë punën që sot, ose maksimumi të hënën.

**ANËTARËT E KOMISIONIT**

- Edi Paloka, kryetar
- Enkelejd Alibeaj
- Myslym Murrizi
- Flamur Noka

**LSI**

- Endrit Brahimllari

**PS**

- Ermonela Felaj
- Klotilda Ferhati
- Pjerin Ndreu
- Paulin Sterkaj
- Xhemal Qefalia
- Bashkim Fino

Në foton familjare Meidani e Nishani, mungon Moisiu e Topi

# Meta merr me vete në Azerbajxhan ish-presidentët, me të edhe Berisha

## *Presidenti fton investitorët: Shqipëria ofron turizëm*




**FORUMI**
Në këtë takim, kryetarë shtetesh aktualë dhe të mëparshëm, kryeministra, ministra dhe akademikë si dhe ekspertë të mirënjohur do të vlerësojnë gjendjen aktuale të botës dhe kërcënimet më të ngutshme të sigurisë dhe paqes ndërkombëtare dhe sugjerojë hapa konkretë për udhëheqjen e sotme për të kapërcyer këto ndarje në formën e një deklarate.

Darina Tanushi

Presidenti Ilir Meta po merr pjesë këto ditë në Forumin e 6-të të Baku-së, në Azerbajxhan. Së bashku me të në këtë forum të 6-të Baku-së me temë: "Mbyllja e boshllëqeve për krijimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse" janë edhe ish-presidentët e Shqipërisë në kohë të ndryshme që nga Sali Berisha, Rexhep Meidani e Bujar Nishani. Nga fotoja familjare e publikuar nga Presidenca shihet se mungojnë Alfred Moisiu dhe Bamir Topi. Madje, ish-presidenti Sali Berisha ka mbajtur edhe një fjalë në këtë forum me temën "Si ndikojnë fuqitë e reja në çështjet globale". "Bota e sotme është një botë plot hendeqe, duke penguar krijimin e një shoqërie me të vërtetë gjithëpërfshirëse, të çliruar nga vështirësitë ekonomike, konfliktet e dhunshme, degradimi intelektual dhe moral. Në një botë që nuk është më njëpolare, por ku një numër fuqish botërore dhe rajonale po rriten fuqishëm, balancat po ndryshojnë duke ndikuar edhe në jetën e shoqërive të vendeve të tjera", u shpreh dje Berisha në "FB". Pak javë më parë, Presidenti Ilir Meta i thirri ish-presidentët në zyrën e tij një e nga një për t'u konsultuar në lidhje me dhënien e autorizimit qeverisë, për nisjen e negociatave me palën greke për një marrëveshje të re për kufirin detar. Kjo është hera e parë që një president afron për diskutimin e një çështjeje kaq të rëndësishme paraardhësit e tij. Dhe forumi i Bakut është hera e dytë që ish-krerët e shtetit takohen me Presidentin Meta. Ndërsa ishte i pranishëm në ceremoninë e hapjes së forumit të 6-të Baku-së, ku marrin pjesë një sërë krerë shtetesh dhe qeverish të vendeve të ndryshme, si dhe një numër i madh politikëbërësish dhe akademikësh, Presidenti Meta u prit në një takim të veçantë nga Presidenti i Republikës së Azerbajxhanit, zoti Ilham Aliyev. Presidenti Meta vlerësoi ecurinë për forcimin gjithnjë e më shumë të marrëdhënieve të



shkëlqyera politike dypalëshe dhe shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Presidenti Aliyev dhe Azerbajxhani i kanë dhënë realizimit të projektit të gazit TAP, si dhe procesit të gazifikimit në Shqipëri. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta vlerësoi edhe mbështetjen e Presidentit Aliyev për projektin tjetër të gazit, IAP (Ionian Adriatic Pipeline), i cili do të ketë një impakt të madh rajonal. Presidenti Meta nënvizoi nevojën e shtrimit të bashkëpunimit dypalësh jo vetëm në fushën e energjisë, por edhe në fusha të tjera, si tregtia, turizmi, arsimi, kultura e të tjera. Presidenti Aliyev e falënderoi Presidentin Meta për ftesën për të vizituar Shqipërinë dhe premtoi realizimin e saj në një kohë sa më të shpejtë.



## Sekuestrimi i 613 kg kokainë, Fatmir Xhafa, opozitës: Qesharakë në sytë e të huajve

Ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj deklaroi sërish se operacioni i 27 shkurtit ku u sekuestruan 613 kg kokainë në Durrës, ishte vepër e Policisë Shqiptare. Gjatë fjalës në Kuvend, Xhafaj sulmoi opozitën lidhur me akuzat që kjo e fundit ka lëshuar këto ditë për qeverinë dhe faktin se kjo e fundit mori sipas saj meritën e aksionit. Xhafaj tha se liderët e opozitës dolën qesharakë dhe baltosës kronikë edhe në sytë e ndërkombëtarëve. "Jo vetëm ne, por edhe partnerët tanë në luftën kundër krimit të organizuar janë të çuditur dhe gati të shokuar për mënyrën se si lidershipi opozitar e përcolli suksesin e sekuestrimit të një sasie të tillë droge. Si është e mundur të nderuar kolegë opozitarë që një pjesë e juaja dhe ca më shumë drejtuesit tuaj politikë, pa pikën e turpit artikulojnë akuza skandaloze për këtë çështje, pikërisht për ata të cilët janë protagonistë në arritjen e këtij rezultati?!", iu drejtua Xhafaj opozitës. "Më vjen sinqerisht keq ta them, por duhet. Disa prej jush janë komplet qesharakë në skenarët e formatit policesk që prezantojnë lidhur me 'kush e solli kokainën, kush ishte garantuesi, pse u ndalua në këtë orë dhe jo në atë, pse nuk la të shkonte tek pritësi, kush i njoftoi, si i njoftoi, pse i njoftoi' etj., etj. Zotërinj, kolegë politikanë, lërjani këtë çështje atyre që e kanë kompetencë hetimin dhe dinë më shumë se ju, por më shumë edhe se ne", tha Xhafaj. "Nëse keni diçka për të thënë, besoj e keni të hapur derën e Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Shkoni atje dhe i tregoni atje çfarë dini dhe çfarë provash kini", sugjeroi ai.

**Ministrja: Opozita kërkoi financime në burime të errëta**

## Gjonaj: Askush nuk do t'i fshihet drejtësisë me akrobaci procedurale



Ministrja e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, kritikoi dje opozitën, duke e akuzuar se është përpjekur të bllokojë Reformën në Drejtësi dhe procesin e vetingut në sistemin gjyqësor. "Në vend që të kërkonit e propozonit zgjidhje për skemën e ndihmës ekonomike, kërkuat financime në burime të errëta dhe shumë të dyshimta për të bllokuar vetingun, zgjedhjet dhe rrugën europiane të Shqipërisë", tha Gjonaj gjatë fjalës së mbajtur në debatin e zhvilluar në seancën plenare të parlamentit. Ministrja theksoi se synimi i opozitës nuk është mbështetja e familjeve në nevojë, por bllokimi i reformave të qeverisë. Sipas ministres, Reforma në Drejtësi ka nisur të japë efektet e para pozitive dhe ajo tashmë është e pandalshme. "Në sistemin e ri të drejtësisë, askush nuk do të ketë mundësi t'i fshihet drejtësisë, duke përdorur akrobaci procedurale, siç keni bërë deri tani dhe as të përfitojë në kurriz të qytetarëve të pambrojtur dhe pa pushtet ekonomik e politik", është shprehur Gjonaj, duke i drejtuar në këtë mënyrë një paralajmërim të drejtpërdrejtë kreut të PD-së. Më tej, Gjonaj nënvizoi se ndihma ekonomike ka qenë për dy dekada dhe më shumë një mekanizëm i padrejtë dhe i korruptuar. Sot me skemën e re, falë kësaj reforme, ndihma ekonomike shkon tek më të varfrit dhe garanton parimin e shpërndarjes së drejtë sipas nevojës. Ministrja më tej i është referuar reformës në drejtësi, si një pjesë e rëndësishme e shtetit social, të cilën tha se po e realizohet për qytetarët, që të mos shpenzojnë më kohë në procese të blera gjyqësore, të mos zvarriten më dyerve të gjykatave dhe të rifitojnë të drejtën e tyre të nëpërkëmbur prej dekadash.

Do të nisë verifikimi për rreth 30 mijë parcela në të gjithë bregdetin

# Pezullimi i tapive me '7501'-shin, Lame: Preket bregdeti dhe zonat strategjike

## *Bllokohen tapitë në 12 qytete, nuk preken fermerët*

Ornela Manjani



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

Të gjitha pronat që janë 1.5 kilometër nga deti, janë vendosur nën hetim prej një task-force të posaçme të ngritur me urdhër të kryeministrit në shkurt të këtij viti. Janë në total rreth 30 mijë parcela toke të cilat do të verifikohen të gjitha në të gjithë vijën bregdetare të vendit. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i ALUIZNI-t Artan Lame dje gjatë një prononcimi për mediat ku bën të ditur se subjekt i verifikimeve do të jenë të gjitha vendimet e marra në këto sipërfaqe qofshin truall, pyje, tokë bujqësore apo tjetër. Ndërkohë për sipërfaqet që nuk janë në bregdet, por i përkasin zonave të përcaktuara për investimet strategjike, pushteti vendor brenda marsit duhet të dorëzojë pranë task-forcës dosjet e plota. Lame ka shpjeguar vendimin e qeverisë për pezullimin e dhënies së tapive në 12 bashki, dhe ka bërë të ditur se gjithçka është në kuadër të këtij procesi të verifikimit. Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame bën të ditur se në bregun e detit janë vënë re abuzime nga komisionet vendore, duke iu ndryshuar statusi nga rërë në sipërfaqe bujqësore, duke i përfshirë në parcelat që ndahen për punonjësit e ish- ndërmarrjeve bujqësore, apo ish-pronarët.

**VERIFIKIMI**

Do të nisë verifikimi për rreth 30 mijë parcela në të gjithë bregdetin. "Është bërë bllokimi, nga ky moment janë dy lloj komisionesh, që janë bllokuar dhe nuk mund të veprojnë më. E para, komisionet vendore që ende pajisnin me AMTP, që ishte një çmenduri e vërtetë. Së dyti, janë të gjithë procedurat që ndiqnin prefekturat, por që nuk e kanë ndjekur deri më sot për mungesë fondesh dhe njerëzish që është punuar goxha gjatë në atë hartë për të përcaktuar një vijë bregdetare dhe një zonë bregdetare që realisht është e abuzuar"-tha Lame. Vendimi i qeverisë sipas kreut të ALUIZNI-t nuk prek procesin e ndarjes së certifikatave të pronësisë për fermerët. "Këtu nuk bëhet fjalë që të ndërpresim regjistrimin e AMTP-ve, regjistrimin e titullit të pronësisë për fshatarët e Spillesë. Gjithë fshatrat e Spillesë kanë marrë tokën me të drejtë me të gjithë rregullat në gjithë atë fushën gjigande të Spillesë, të cilat i punojnë dhe mbajnë familjet. Nuk bëhet fjalë për t'i bllokuar ato", - tha Lame. Ndër të tjera verifikimi i pronave në bregdet bëhet edhe me synimin për të shmangur problemet me pronat për investimet strategjike. "Biem dakord të gjithë që nuk ka investime në turizëm pa grumbulluar tokën, pa pasur parcela të mëdha ku mund të investohet në to dhe pa pasur të pastruar nga gjithë ajo moria e pronarërucve që dalin sa herë dikush bën provë të ngulë një shkop në bregdet dhe të thotë këtë pronë këtu e kam marrë nga qeveria dhe do të investoj. Menjëherë shohim pastaj që dalin pronarë me letra, pa letra, pronar që e kam nga babai, gjyshi",-tha Lame.

> **ABUZIMET**
>
> Kreu i ALUIZNI-t Artan Lame bën të ditur se në bregun e detit janë vënë re abuzime nga komisionet vendore, duke iu ndryshuar statusi nga rërë në sipërfaqe bujqësore, duke i përfshirë në parcelat që ndahen për punonjësit e ish-ndërmarrjeve bujqësore, apo ish-pronarët.

**VENDIMI**

Vendimi për pezullimin e përkohshëm të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike është marrë në mbledhjen e qeverisë të zhvilluar në Elbasan dhe është botuar në Fletoren Zyrtare dhe në bazë të tij bashkitë që preken janë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol. Në vendimin e qeverisë, thuhet, gjithashtu, se objekt do të jenë pronat e ish-kooperativave dhe ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilat janë në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike. Qeveria urdhëron njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme që të zbatojnë vendimin pavarësisht nga faza procedurale ku janë.

**SHITBLERJA**

Kreu i ALUIZNI-t i bëri thirrje pak ditë më parë qytetarëve që të bëjnë kujdes në blerjen e tokave pranë detit për të shmangur mashtrimet. Ndërsa në verifikim do të jenë hartat e tokave, dhe dokumentet që kanë marrë në konsideratë komisionet e ndarjes së tyre. "Qeveria synon t'i japë fund këtij procesi të turpshëm dhe t'i rikthejë shtetit shqiptar tokat e grabitura në këtë mënyrë. Do të bëjë krehjen e vendimmarrjes abuzive përgjatë gjithë vijës bregdetare për ta çliruar atë nga ngërçi pronësor. Këtij procesi ligjvënës do t'i nënshtrohen rreth 30 mijë parcela përgjatë gjithë bregdetit shqiptar",-tha Lame.

> **VENDIMI PËR BLLOKIMIN E KALIMIT TË TOKËS NË PRONËSI**
>
> 1. Pezullimin e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike.
> 2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, territori administrativ i të cilave përfshihet në hartën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, të pezullojnë procedurat e kalimit në pronësi të tokës së ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës, në zonën me rëndësi për fondin e mbështetjes së investimeve strategjike, pavarësisht nga faza procedurale, menjëherë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.
> 3. Procesi bllokohet në bashkitë Shkodër, Lezhë, Kurbin, Durrës, Kavajë, Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Vlorë, Himarë, Sarandë dhe Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

---

### Vorbsi: S'mund të hiqet titulli i pronësisë

## Shoqata e pronarëve, kundër vendimit të qeverisë

Pezullimi i përkohshëm i dhënies së certifikatave të pronësisë për ata që përfituan tokë nga ligji 7501 dhe ai i ndarjes së tokave të ish- ndërmarrjeve bujqësore, është një vendim që i heq të drejtën e pronësisë pronarëve dhe ia jep këtë të drejtë investitorëve. Shqetësimi ngrihet nga kryetari i Shoqatës Kombëtare "Pronësi me Drejtësi", Myrshit Vorpsi, i cili thotë, se nga vendimi preken 26 mijë pronarë, që kanë përfituar apo prisnin të përfitonin nga kthimi i pronave. "Këtu preken të gjithë pronarët e atyre 26 mijë vendimeve, të cilët duhet të kompensoheshin qoftë edhe fizikisht nga shteti. Qëllimi është i mirë, por mjeti që kanë gjetur është i gabuar. T'i heqësh titullin e pronësisë, sepse do t'ia japësh dikujt tjetër, kjo nuk shkon. Po digjen të gjithë ata posedues të titujve të pronësisë, pavarësisht sesi i kanë përfituar, si dhe ata që janë në kërkim të një prone aty"-thotë Myrshit Vorpsi, kryetari i shoqatës kombëtare "Pronësi me drejtësi. Sipas Vorpsit, Pronarët e vërtetë mund të kompensohen, por me prona që janë në zona pa perspektivë zhvillimi, që tashmë janë përcaktuar nga qeveria. "Pronarët e vërtetë ngelen për të shkuar dhe përfituar në 23 mijë parcelat e tokës që janë në malësitë e Gramshit, Skraparit, Elbasanit, Korçës, fshatra që edhe po të shkosh atje njerëzit do pyesin: Ku bie ky fshat?",-thotë Vorbsi. Pezullimin, Vorpsi e konsideron si një vendim që bëhet për interesa elektorale, ku kryetarët e bashkive kanë fuqi t'i japin prona personave që nuk kanë përfituar nga ligji 7501.



Kryetari i Shoqatës Kombëtare "Pronësi me Drejtësi", Myrshit Vorpsi

### Bashkëshorti: Për të helmuar nënën time, Marjana u konsultua me familjarët e saj

# "Marjanën e përzura nga shtëpia 5 muaj para vrasjes, po përleshej me mamanë"

## Olti Lami: Pas varrimit pashë se gruaja ime kishte shenja në trup



Olti Lami dhe Marjana Çmeta



Viktima Lirie Lami

Mamaja me Marjanën kanë pasur më herët konflikt me njëra-tjetrën. Një ditë i gjeta në dhomën time duke u zënë. I ndava në atë moment, por Marjanën e largova nga shtëpia. Vetëm për faktin që nëna ime e donte, e falëm prapë dhe e morëm në shtëpi". Kështu është shprehur Olti Lami, ish-bashkëshorti i Marjana Çmetës, vajzës e cila akuzohet se helmoi me fostoksinë mamanë e tij. Lami i tronditur nga fakti se pas vrasjes së nënës së tij, fshihet ish-bashkëshortja, tregon se Marjana ka pasur konflikte më vjehrrën edhe 5 muaj para se të ndodhte tragjedia. Ai thekson se një nga debatet mes 21-vjeçares dhe Liries kishte degraduar deri në dhunë fizike mes vjehrrës dhe nuses, për këtë arsye e kishte përzënë Marjanën nga shtëpia, por këmbëngulja e nënës së tij e kishte kthyer të renë sërish në banesë. Më tej, Olti tregon se kishte pasur dyshime tek nusja e tij edhe pas varrimit të nënës. "Mami kishte shenjën e kafshimit në fytyrë dhe gërricje me thonj në pjesën e buzës. Një ditë pas varrimit të saj (Marjana) më tha mua do vish pak tek dhoma se kam frikë për t'u ndërruar. Po mirë thashë, po vij me ty dhe kur hoqi bluzën i pashë disa shenja të zeza në krah. E pyeta se ku i kishte bërë ato shenja dhe më tha që ia kishin bërë gratë ditën e varrimit, duke i thënë të mos qante. Ajo domethënë nuk ka qarë fare atë ditë vetëm se rrinte me kokën ulur dhe aty më hipën shumë dyshimet që kjo ka gisht në këtë pjesë",- thotë Olti. Ndërkohë pesë ditë pas vdekjes së mamasë, kur nga morgu iu mbërrin dokumenti se 48-vjeçarja Lirije Lami ishte vrarë, nusja largohet nga shtëpia. Dyshimet e shumta që rëndonin mbi Marjanën, e dërguan Oltin tek hoxhë Hyseni për të kërkuar ndihmë. I riu shprehet se aty mësoi për ekzistencën e videos dhe të vërtetën e tmerrshme që Marjana ishte vrasësja. Ai tregon se për këtë krim, ish-bashkëshortja ishte konsultuar me dy familjarët e saj. "Ndodhej me fytyrë komplet, ishte ulur në një divan dhe tregonte komplet ngjarjen se si e mbyti. Thoshte që e thirra hajde futu brenda tek shtëpia dhe i dhashë një lëng portokalli. I thashë merre këtë lëngun se na e ka dhënë një hoxhë për të na bërë mirë të gjithëve, e kemi pi të gjithë, pije dhe ti, por ka pak erë të rëndë, por këtë e kemi pirë të gjithë ne. Dhe mami siç thoshte ajo, kishte thënë po mirë do e pi edhe unë që të na bëjë mirë të gjithëve. I tha hoxhës se ka pyetur mamin dhe vëllain e saj, pasi nuk mund ta merrte një vendim të tillë pa pyetur familjen e saj", tregon Olti Lami. Ndërsa ish-bashkëshortja e tij ndodhet pas hekurave, nuk dihet çdo bëhet me fatin e fëmijës 5 muajsh që Olti nuk i ka dhënë ende atësinë. "Akoma nuk ia kam dhënë atësinë, kjo është çështje për t'u menduar gjatë",- thotë më tej Olti.


**Lajmërim**

Me hidhërim të thellë familja Mitri njofton vdekjen e babait, **Toufik Mitri**, në 13 Mars 2018, në Tiranë.

Ceremonia kishtare do të mbahet **ditën e diel 18 Mars** në orën **11:30**, tek Kisha Orthodhokse, Rruga e Kavajës, Tiranë.

Varrimi do të kryhet mbas ceremonisë kishtare tek varrezat e Tufinës. Pas ceremonisë mortore dreka do të mbahet tek Restorant "Sofra e Ariut", Rr: e "Elbasanit", Tiranë.

**Toufik Mitri ishte babai i Selim, Joseph, Karim dhe Fadi Mitri.**

**Death Announcement**

Mitri Family announces with great sadness the loss of their beloved Father, **Toufik Mitri**, on March 13th, 2018, in Tirana, Albania.

Church ceremony will be held on **Sunday 18th March**, at **11:30 am**, at Orthodox Church, at Kavaja Street, Tirana.

Interment will follow the church service at Tufina Cemetery. After burial ceremony, lunch will be held at "Sofra e Ariut" Restaurant, "Elbasani" Street, Tirana.

**Toufik Mitri is the father of Selim, Joseph, Karim and Fadi Mitri.**


### Dosja 'Habilaj', zgjatet hetimi për ish-kreun e policisë së Vlorës

## U ekstradua në Itali, Nezar Seiti dëshmon në prokurorinë e Katanias



Nezar Seiti

**JAELD ÇELA**

Ish-drejtori i policisë së Vlorës dyshohet se ka marrë një SMS urimi nga Florian Habilaj. Avokati mbrojtës i Jaeld Çelës, Petrit Ismaili pretendon se nuk janë njohur me faktet. "Klienti im po paragjykohet. Nuk mund të implikohet për një mesazh urimi që ka marrë për Vitin e Ri, në 2016 nga Florian Habilaj", - tha avokati i Çelës.

**ITALI**- Pak kohë pas ekstradimit në Itali, financieri i grupit kriminal të drogës, 'Habilaj', Nezar Seiti ka dëshmuar në prokurorinë e Katanias. Seiti ka dhënë shpjegime dhe hollësira në organin e akuzës së Katanias, dëshmi që do t'i vihet në dispozicion edhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Më herët Krimet e Rënda i kanë drejtuar letërporosi autoriteteve italiane, ku kërkohej ndihmë për hetimin e çelur ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri. Në letërporosi theksohej fakti se gjatë qëndrimit në paraburgim në vendin tonë, Seiti ka refuzuar të japë shpjegime rreth çështjes. Ndërkohë ditën e djeshme krimet e rënda zgjatën afatin e hetimeve për ish-drejtorin e policisë Vlorë Jaeld Çela me tre muaj. Çela dyshohet për përfshirje në trafik droge me bandën e Habilajve. Vendimi u mor pas kërkesës së prokurorit Dritan Premçi, i cili tha se po kryhen transkriptimet e dy viteve përgjim ndaj Çelës. Për më tepër janë nisur letërporosi në Itali e Greqi në kuadër të hetimeve të kësaj çështjeje dhe priten përgjigjet nga autoritetet e këtyre dy vendeve. Seanca e radhës për Jaeld Çelën do të mbahet më 19 mars. Nga ana tjetër, avokati mbrojtës i Jael Çelës, Petrit Ismaili pretendon se nuk janë njohur me faktet. "S'jemi njohur me faktet. Janë duke u transkriptuar përgjimet telefonike të Jaeldit dhe grupit Habilaj për të parë implikimin e tij lidhur me akuzat. Klienti im po paragjykohet. Nuk mund të implikohet për një mesazh urimi që ka marrë për Vitin e Ri në 2016 që ka marrë nga Florian Habilaj", tha avokati i Çelës. Ish-drejtori i policisë së Vlorës dyshohet se kishte marrë një sms urimi nga Florian Habilaj. Urdhërarrestet për Jaeld Çelën dhe dy ish-zyrtarë të tjerë të policisë së Vlorës, Gjergji Kohila dhe Sokol Bode u lëshuan në nëntor të vitit të kaluar, por ata janë ende në kërkim.




## Trafikonin kokainë dhe marijuanë, përfundojnë në pranga 10 persona, mes të cilëve 2 shqiptarë

**ITALI** - Policia italiane ka goditur dje një grup trafikantësh droge, duke arrestuar 10 persona, 2 prej të cilëve shqiptarë. Bëhet fjalë për 31-vjeçarin Elio Çela dhe 38-vjeçarin Marigen Abdurramani. Akuza ndaj tyre është trafik droge e tipit kokainë e marijuanë si dhe armëmbajtje pa leje. Operacioni i koduar "Sta senz' pensier" ka zbardhur se kjo organizatë trafikonte drogë në rajonet e Kampanjës, Abruzzo e Marke. Gjatë operacionit janë sekuestruar 2 kg kokainë, 4 kg hashash, 1 kg marijaunë, disa gramë metanfetamina, 9 590 euro kesh, një pistoletë me numër kalibri të fshirë e 230 plumba të kalibrave të ndryshme. Mësohet se lënda narkotike trafikohej me automjete të vogla (për kamuflim) nga rajoni i Kampanjës në Abruzzo e Marke e më pas shpërndahej në lokalet e natës të frekuentuara sidomos nga të rinjtë. Shqiptarët e arrestuar janë rezidentë në Itali. Marigen Abdurramani në komunën Martinsicuro, në rajonin e Aruzzos, ndërsa Elio Çela në Grottammare në provincën e Ascoli Picenos në rajonin Marke. Katër prej të arrestuarve u lanë nga gjykata në "arrest shtëpie", ndërsa pjesa tjetër, përfshirë edhe dy shqiptarët, u lanë në "arrest me burg".

### 2.3 tonë drogë me skafe drejt Italisë, trafiku drejtohej nga 3 shqiptarë

# "Shefi", 21 shqiptarët e arrestuar, pjesë e grupeve në Durrës dhe Vlorë

## U zbuluan nga përgjimet telefonike me persona të skeduar

**TIRANË**

21 shqiptarët e arrestuar si pjesë e dy organizatave kriminale të trafikut të kanabisit dhe kokainës nga Shqipëria drejt Italisë që u shkatërruan mëngjesin e së mërkurës gjatë një operacioni të përbashkët të policive të dy vendeve fqinje kishin lidhje me grupe kriminale që operonin në zonën e Vlorës dhe atë Durrësit. Sipas "Report TV", burime nga Policia e Shtetit konfirmuan se 4 shqiptarët e arrestuar në Tiranë dhe 17 të tjerët në Itali janë përgjuar teksa komunikonin me telefon me persona të skeduar si trafikues kanabisi drejt Italisë. Shqiptarët janë zbuluar nga përgjimet telefonike dhe ambientale për trafikun e drogës, që bënin nga Shqipëria nëpërmjet gomoneve, drejt vendit fqinj. Mësohet se këto dy grupe kriminale në Vlorë dhe Durrës janë të identifikuara edhe nga Task-Forca që ka ngritur Ministria e Brendshme. Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe policia do të vijojnë hetimet për këto dy grupe kriminale, ndërkohë që 20 shqiptarët e arrestuar do akuzohen për krijimin e grupit kriminal dhe për trafik narkotikësh.

Deri më tani bëhet me dije se trafiku drejtohej nga 3 shqiptare, të cilësuar si koka e rrjetit. Operacioni "Shefi" ka nisur hetimet në maj të vitit 2016 nga antimafia italiane e qytetit të Barit dhe kanë zgjatur dy vite, deri në janar 2018. Hetimet intensive kanë zbuluar se shqiptarët e arrestuar janë organizatorë, korrierë dhe magazinierë të kanabisit dhe kokainës. Shqiptarët që u kapën në Tiranë siguronin kanabisin dhe më pas e nisnin në Itali, ku merreshin të tjerë shqiptarë dhe të huaj. Në këto operacione janë sekuestruar rreth 2300 kg lëndë narkotike të llojit marijuanë, heroinë dhe kokainë, me vlerë tregu 15 milion euro.

**15 MLN EURO**

Nga hetimet ka rezultuar se dy grupeve kriminale të trafikut ndërkombëtar të drogës, në kohë dhe vende të ndryshme u janë sekuestruar mbi 2.3 tonë lëndë narkotike kanabis, heroinë dhe kokainë me një vlerë që shkon deri në 15 milionë euro.


Droga e kapur në Itali

**OPERACIONI "SHEFI"**

Departamenti i antimafies italiane, DIA, shkatërroi një rrjet italo-shqiptar të trafikut të drogës nga Shqipëria me skafe drejt Italisë, në bregdetin e Barit. Në prangat e policisë kanë rënë 43 persona, mes të cilëve italianë, shqiptarë dhe rumunë. Mësohet se katër nga anëtarët e dy organizatave kriminale janë arrestuar në territorin shqiptar, ndërsa pjesa tjetër në Itali, në qytetet e Barit, Brindisit, Bolonjës dhe rrethinat e tyre. Shqiptarët e arrestuar në këtë operacion antidrogë janë: Dritan Naci, 32 vjeç; Marglen Shusha, 32 vjeç; Marlin Aliaj, 33 vjeç; Andi Peshku, 25 vjeç; Vullnet Daci, 31 vjeç; Gëzim Bircaj , 54 vjeç; Malton Lleshi, 35 vjeç; Fiqiret Seferi, 54 vjeç; Ernest Peza, 27 vjeç; Lenoidha Sejdiaj, 52 vjeç; Elton Ismaili, 39 vjeç; Samuel Muça, 31 vjeç; Ferhat Ajdini, 45 vjeç; Vullnet Cila, 39 vjeç; Shpëtim Shehi, 39 vjeç; Donial Drolli, 29 vjeç; Ibrahim Xhihani, 26 vjeç; Ergent Seferi, 28 vjeç; Arian Kertusha, 48 vjeç; Senat Hallunaj, 23 vjeç; Hamid Seferi, 24 vjeç. Autoritetet italiane kanë bërë të ditur se në këtë aksion janë angazhuar mbi 200 punonjës të departamentit të antimafias, DIA, Guardia di Finanza, karabinerisë si dhe policisë shqiptare. Ndërkaq, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë në Tiranë tregohet mjaft e rezervuar për këtë operacion.

## U kapën me 1.5 kg heroinë, pranga 'bosëve' shqiptarë të drogës e prostitucionit

**FRANCË** - Dy shqiptarë kanë rënë në prangat e policisë franceze, pasi akuzohen se ishin pjesë e një rrjeti kriminal që vepronte në zonën Rhône në l'Isère të Francës. Të rinjtë u kapën me të paktën 1.5 kg heroinë, 30 mijë euro para kesh dhe rreth 40 kg produkte përzierës, që do t'i përdornin për të shitur drogën me pakicë, shkruan "Le Dauphine". Ishte prokuroria e Grenoble që hapi një hetim gjyqësor për shqiptarët. Mediat franceze flasin për një organizatë kriminale të trafikut të drogës në Francë dhe në Holandë. Ky rrjet është i gjithashtu i përfshirë edhe në shfrytëzim prostitucioni të vajzave rumune në rajonin e Grenoble. Mendohet se dy shqiptarët e arrestuar së fundmi ishin pjesë e strukturave të larta të organizatës kriminale.



### SHKURT

#### Montonte bomba me celular, lihet në burg Gentian Hoxha

TIRANË - Në reanimacionin e spitalit të Traumës, ku mbahet për kurim, Gentian Hoxha u njoh ditën e djeshme me masën e sigurisë "arrest me burg". Ai pësoi dëmtime të rënda nga shpërthimi në dyqanin e tij të celularëve, ku dyshohet se montonte bomba. Bëhet me dije se Hoxha është marrë edhe më parë me montimin e lëndëve plasëse në celular. Ai kishte marrë një dyqan me qira për të kamufluar punën që kryente. Në këtë ambient, Hoxha kishte krijuar një dhomë të dyfishtë për të fshehur detonarorët dhe kapsollat. Mësohet se lëndën shpërthyese, 34-vjeçari e siguronte në qytetin Fushë-Krujës.

#### Kapet menaxheri shqiptar i hoteleve që krijoi bandën kriminale

ITALI - Dritan Idrizaj është menaxheri shqiptar i hoteleve në Pietra Ligure, i cili u arrestua në Itali për kamatë, mashtrim dhe zhvatje. Mediat italiane raportojnë se shqiptari së bashku me persona të tjerë kishin krijuar një organizatë mes Imperia dhe Albenga, përmes të cilës huazonin para për sipërmarrësit lokalë. Idrizaj, sipas rindërtimit të skemës nga hetuesit, ishte përgjegjës për "tërheqjen" e viktimave, të cilët shpesh e dinin. Nëse nuk mund të paguanin borxhet, sipërmarrësit kërcënoheshin nga banda. Një furnizues ushqimesh, i cili në të kaluarën kishte pasur Idrizajn si punonjës, u detyrua të kthente 600 mijë euro dhe duke u dhënë kriminelëve pronat. Për disa raste të tjera nuk u gjetën prova.

**Shoqëria Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k**
**shpall Ankandin për shitjen e pasurisë së paluajtshme:**

*Pasurisë me Nr. 7/34, e llojit "Apartament ", me sip. 50.2 m², dhe sip.trualli 19 m², ndodhur në Q. Memaliaj, Tepelenë ZK.2646,*në pronësitë **Skënder Feta Muka.** Çmimi fillestar në ankandin e parë është 537,124.64 Lekë.

Ankandi zhvillohet në datë **19.03.2018, ditën e Hënë ora 15.30** në ambjentet e **Shoqërisë Përmbarimore "AFA-2010" sh.p.k në adresën Rruga "Sulejman Delvina", Nd.51, H.9, Ap.1, Tiranë. Për më shumë info.** Tel:044503458 **ose E-mali** shoqeriapermbarimoreafa2010@gmail.com

**NJOFTIM ANKANDI**

**Permbarues gjyqesor privat Artan Sima** zhvillon ankandet sipas datave te meposhtme:

**Date 16/04/2018, diten e Hene, ora 16:00,** perfundon ankandi i ri (i dyte), per shitjen e pasurive te paluajtshme te llojit "Are" me sip. 7400 m2, e ndodhur ne fshatin Bitince Devoll, ne vleren 414,400 leke.
Pasurite jane lene garanci bankare nga debitori Trashegimtareve te te ndjerit/Debitor znj.Bukurije Sulejman Fezo, znj.Mimoza Fatmir (Foto) Fezo, z.Xhimi Foto Fezo, znj. Arkonnda Foti Fezo, znj. Eliverta Foti Fezo, znj. Luiza Foti (Kasabelli) Fezo banues ne fshatin Bitince, bashkia Devoll, per detyrimin ndaj kreditorit Fondi Besa Sh.a, me seli ne ish Blloku Tirane. **Ankandet zhvillohet prane zyres se permbaruesit me seli lagjen nr.3, Rruga Avni Rustemi, nr.31 .k,1. Korce. Kontakt Cel.0674044666, e-mail. simaartan@yahoo.com**

**NJOFTIM SHITJE ME ANKAND**

**ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'**

**A.** Automjetit tip 'SKODA', ngjyrë 'GRI', vit prodhimi '2009', nr. shasie TMBDG41U4A8840601, me targë 'TR 2338 T' , në pronësi të dorëzanësit z. ALKET Suad KOTONI, ÇMIMI 120.000 LEKË ;
**B.** Automjetit tip 'HYUNDAI', ngjyrë 'GRI', vit prodhimi '2009', nr. shasie MALAM51CBAM416803, me targë 'AA 714 BH' , në pronësi të dorëzanësit znj. AIDA Luan KOTONI , ÇMIMI 130.000 LEKË .
**Data e zhvillimit të ankandit do jetë 21.03.2018 .**
**CEL. 0684026666 ; 0693262866**

"Mos qëndroni me orë të zgjatura jashtë institucionit, mjaftojnë 10-15 minuta"

# Ambasada amerikane: Ja sa duhet të prisni për të marrë vizën

## *Cilat janë klasifikimet e vizave joemigruese*

Voltiza Duro

Të gjithë të interesuar it që dëshirojnë të aplikojnë për vizë në Shtetet e Bashkuara gjatë 2018-ës mund të ndjekin rekomandimet e dhëna nga ambasada amerikane. Kjo e fundit ditën e djeshme ka bërë me dije se aplikuesit duhet të paraqiten vetëm 10-15 minuta para kohës së përcaktuar dhe jo orë më përpara. "A e dini se duhet të paraqiteni në ambasadë vetëm 10-15 minuta përpara kohës së caktuar për vizë? Nuk ka nevojë që të vini me orë përpara, apo të prisni në radhë jashtë murit të ambasadës. Nëse po udhëtoni nga jashtë qytetit dhe jeni herët për takimin tuaj, shkoni në një kafene dhe shijoni një kafe", - theksohet në njoftimin e ambasadës.

**KLASIFIKIMET E VIZAVE**

Akti i Emigracionit dhe Kombësisë parashikon disa kategori të vizave joemigruese për një person që dëshiron të punojë përkohësisht në Shtetet e Bashkuara. Vizat e klasifikuara H-1B u aplikohen personave me një profesion të specializuar, i cili kërkon aplikimin teorik dhe praktik të një sërë njohurish tepër të specializuara, njohuri për të cilat kërkohet përfundimi i një kursi specifik të një arsimi më të lartë. Ky klasifikim kërkon një dëshmi pune lëshuar nga Sekretari i Punës. Ndërkaq, vizat që njihen si H-1C u aplikohen infermierëve të huaj që vijnë për të kryer shërbime nëpër spitale për një periudhë të përkohshme deri në tri vite, kurse vizat e klasifikuara H-2A u aplikohen punëtorëve të përkohshëm ose sezonalë të agrikulturës. Më tej, në faqen zyrtare të ambasadës amerikane citohet se vizat e klasifikuara H-2B u aplikohen punëtorëve të përkohshëm ose sezonalë të joagrikulturor. Ky klasifikim kërkon një certifikatë pune të lëshuar nga Ministria e Punës. "Vizat e klasifikuara H-3 u aplikohen personave që trajnohen për punë të ndryshme, por jo për ata që trajnohen për mjekësi apo akademi. Ky klasifikim u aplikohet gjithashtu edhe personave që trajnohen për edukimin e fëmijëve handikapatë", - bën me dije ambasada. Ndërkaq, vizat e klasifikuara L u aplikohen personave që shpërngulen nga njëra degë e kompanisë, ku punojnë në një degë tjetër në SHBA të cilët, brenda 3 viteve të mëparshme kanë punuar jashtë në vazhdimësi për një vit dhe që do të punësohen në një degë apo filial të të njëjtit punëdhënës në SHBA, në menaxhim ekzekutiv ose në punë të ndryshme të specializuara. Vizat e klasifikuara O-1 u aplikohen personave që kanë aftësi të jashtëzakonshme në shkencë, art, edukim, biznes, atletikë, ose që kanë arritje të jashtëzakonshme në fushën e televizionit dhe të ekranit, ndërsa ato O-2 u aplikohen personave që shoqërojnë mbajtësin e vizës O-1, të cilët ndihmojnë atë në një shfaqje artistike apo aktivitet atletik. Ndërkohë, viza e klasifikuar P-1 i aplikohet një atleti ose një skuadre atletësh, ose anëtarëve të një grupimi zbavitës, të cilët janë të njohur në tërë botën, ndërsa vizat P-2 i aplikohen artistëve, të cilët do të shfaqin sipas një programi shkëmbimi reciprok e ato P-3 u jepen artistëve, të cilët do të shfaqin sipas një programi, i cili është kulturalisht unik (e njëjtë si vizat P-1). Ambasada bën me dije se vizat e klasifikuara Q-1 u aplikohen pjesëmarrësve në një program shkëmbimi kulturor ndërkombëtar për qëllim që të përfitojnë trajnim praktik, punësim dhe që të shkëmbejnë historinë, kulturën dhe traditat e vendit të aplikantit.



**KLASIFIKIMI I VIZAVE TË PËRKOHSHME NË SHBA**

| | |
|---|---|
| **H-1B** | U aplikohen për personat me një profesion të specializuar. |
| **H-1C** | u aplikohen infermierëve të huaj. |
| **H-2A** | u aplikohen punëtorëve të përkohshëm të agrikulturës. |
| **H-2B** | u aplikohen punëtorëve të përkohshëm të joagrikulturorë. |
| **H-3** | u aplikohen personave që trajnohen për punë të ndryshme. |
| **L** | u aplikohen personave që shpërngulen nga një degë e kompanisë në një tjetër. |
| **O-1** | u aplikohen personave që kanë aftësi të jashtëzakonshme në shkencë, art, edukim, biznes, atletikë ose që kanë arritje të jashtëzakonshme në fushën e televizionit dhe të ekranit. |
| **O-2** | u aplikohen personave që shoqërojnë mbajtësin e vizës O-1. |
| **P-1** | i aplikohet një atleti ose një skuadre atletësh, ose një grupimi zbavitës. |
| **P-2** | u aplikohen artistëve, të cilët do të shfaqin sipas një programi shkëmbimi reciprok. |
| **P-3** | u aplikohen artistëve, të cilët do të shfaqin sipas një programi kulturalisht unik. |
| **Q-1** | u aplikohen pjesëmarrësve në një program shkëmbimi kulturor ndërkombëtar. |


**SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"**
**SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER:**

1. **Are** me nr.33/26, e ndodhur ne Karpen, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099,vol.11, fq.202, me sip.2,000 m2, cmimi që do të shitet është **3.942.960** lekë.
2. **Are** dhe truall me **nr.1/88**, e ndodhur ne Qerret, Kavaje, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.9, fq.34, me sip.1,770 m2 cmimi që do të shitet është **9.770.655** lekë.
3. **Are** me nr.33/27, e ndodhur ne Karpen. Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.2099, vol.1, fq.203, me sip.4,050 m2 cmimi që do të shitet është **7.984.494** lekë.
4. **Are** me nr.70/9, e ndodhur ne Qerret, Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.3101, vol.2, fq.106, me sip.6,460 m2 cmimi që do të shitet është **5.094.305** lekë.
5. **Njësi** me nr.15/22+1-N1 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/69, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.116 m2 vlerësohet me vlerën e **10.062.434** lekë.
6. **Njësi** me nr.15/22+1-N2 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 14/70, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.91 m2 vlerësohet me vlerën e **7.893.806** lekë.
7. **Njësi** me nr.15/22+1-N3 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/71, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.95 m2 vlerësohet me vlerën e **8.240.786**lekë.
8. **Njësi** me nr.15/22+1-N4 e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551,nr.rregjistri hipotekor 15/72, vl.2011, datë 03.03.2011 me sip.211 m2 vlerësohet me vlerën e **18.303.221** lekë.
9. **Bodrum** me nr.15/22+1-B e ndodhur ne Kavajë, rregjistruar në ZVRPP Kavajë, Zk.8551, nr.rregjistri hipotekor 130/176, vl.2005-2007, datë 24.09.2007 me sip.609 m2 vlerësohet me vlerën e **14.734.842** lekë.

Te gjitha pasurite e sipërcituara jane hipotekuar në favor te **Banka Raiffeisen sha.** Ankandi zhvillohet ne **datë 09.04.2018 ora 16.00** në adresen Rr."I. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane. Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al



**The European Union Delegation to Albania is looking for**

**ADMINISTRATIVE ASSISTANT**

With main focus on

***Human Resources Management and Protocol Issues***

**We offer**

- ***Multicultural working environment***
- ***Competitive salary***
- ***Benefits by law***

**For complete information and application, please refer to:**
**https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en**
**"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"**
**Deadline for applications: 31/03/2018**

PENSIONET E PLEQËRISË
INTERVISTA

Eksperti: Kriteret dhe dokumentacioni, si duhet të veproni kur humb libreza e punës

# Sabah Goci: Si të përllogarisni pensionet e pleqërisë

## "Formula bazë, koeficientët përkatës para dhe pas '94"



Foto ilustruese



Voltiza Duro

Pensionistët shpesh herë nuk janë të qartë në lidhje me përllogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë që iu takon e ankesat e tyre adresohen drejt Institutit të Sigurimeve Shoqërore apo dhe ekspertëve të fushës. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", Sabah Goci, me një eksperiencë mbi 21 vjeçare pranë ISSH-së, tregon formën e saktë për llogaritjen e masës së pensionit, në mënyrë që qytetarët të mos gabojnë. Eksperti thotë se mosha dhe vitet e punës me kontribute janë dy kriteret bazë për të përfituar pension pleqërie e më tej shprehet se prej 1 janarit të 2015-ës, janë futur elementë të rinj brenda formulës, duke përfshirë edhe pensionin social. Më tej, Goci shpjegon për të gjithë të interesuarit pagën referuese dhe koeficientët e indeksimit të pagës si dhe formulën e llogaritjes së masës, e cila është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet. Gjithashtu, eksperti i pensioneve tregon për lexuesit të gjithë dokumentacionin që duhet të paraqesin të interesuarit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe mënyrën si duhet vepruar në rastet kur humb libreza e punës.



Sabah Goci ekspert pensionesh

> "Masa e pensionit sot në Shqipëri është e vogël dhe politika e di këtë. Por dhe kontributet që janë derdhur janë në nivel minimal, në paga minimale. Një pension minimal shkon rreth 9 mijë lekë të reja në muaj"

**Çfarë është pensioni i pleqërisë dhe cilat janë kriteret për ta përfituar atë?**

Pensioni i pleqërisë nënkupton marrjen e një të ardhure kur individi e humbet aftësinë për punë, jo për shkak të gjendjes shëndetësore, por për efekt të moshës. Mbi moshën dhe gjendjen e një personi janë përcaktuar e vlerësuar dhe kriteret e marrjes së pensionit të pleqërisë, bazuar në ligjin 7703. Ky i fundit nënkupton trajtimin me përfitime afatgjata të grupeve të interesit (individët kandidatë për të dalë në pension), të cilët është mirë që të kenë sa më shumë vite pune me kontribute. Për të përfituar pension duhet që kandidati të ketë jo më pak se 15 vite punë si për gratë dhe për burrat. Ndërkaq, ky pension merret kur burri kalon moshën 65 vjeç, e kur gruaja mbush moshën 60 vjeç e 8 muaj për vitin 2018-të. Por mosha e daljes në pension për gratë është fleksibël, pasi në 2019-ën, mosha e daljes në pension për gratë do të jetë 60 vjeç e 10 muaj.

**Cilat janë disa nga ndryshimet që janë bërë në formulën e përllogaritjes së pensionit pas reformës së 2014-ës?**

Vetë formula e përllogaritjes së pensionit, e cila është ndryshuar duke filluar nga 1 janari i 2015-ës, ka futur elemente të reja brenda saj duke futur edhe pensionin social. Ky i fundit është stabël, fiks, niveli i të cilit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Pensioni social i jepet çdo personi që del në pension pleqërie kur mbush moshën.

**Si bëhet llogaritja e pensionit të pleqërisë?**

Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: Pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet. Një qytetar që ka filluar punën në vitin 1975 deri në 2018-ën, pa ndërprerje, ka 43 vite pune me kontribute. Pensioni do të llogaritet nga viti 75' kur individi ka filluar punë për herë të parë, deri në 2018-ën me pagat që ai ka gëzuar. Por meqenëse gjatë viteve të tranzicionit, u dëmtua dokumentacioni dhe nuk mund të gjendeshin dokumentet e pagave për pensionistët, në 2007-ën, u mor një vendim i Këshillit të Ministrave që quhet "Vendimi i Këshillit të Ministrave për pagën mesatare për bazën e vlerësuar për efekt llogaritje të pensioneve" ose siç quhet ndryshe paga referuese. Ky është një vendim unik që ka të pacaktuar në disa tabela të veçanta llojin e punës që ka bërë individi nga dita që ka filluar punën deri në ditën që e ka lënë atë.

**Çfarë është paga referuese?**

Në rastin kur një individ ka qenë mësues për 40 vite dhe ka pasur një pagë mësuesi, duhet që patjetër këtë funksion që ka pasur ta ketë të shprehur qartë në librezën e punës. Pra, nuk i kërkohen vërtetime pagash nga viti që ka filluar punën por i kërkohet vetëm një librezë pune e pastër, e plotësuar sipas dispozitave të kohës dhe e pakorrigjuar, e pa ndërhyrë brenda saj. Ky është një dokument themeltar mbi të cilin llogaritet pensioni para vitit 93'. Këto paga referuese i shërbejnë individit nga dita që ka filluar punë deri në 31 dhjetor të 1993-it e këto paga kanë koeficentët e vet të indeksimit.

**Si duhet ta kuptojnë qytetarët termin "koeficient indeksimi" dhe për çfarë shërben ky koeficient?**

Koeficientët e indeksimit janë ata koeficentë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra t'i heqin efektin "gërryes" të inflacionit. Paga e një mësuesi që ka filluar punën me kontribute në 1975-ën, deri në janar në 94-ën, me gjithë indekset e ndryshimet që kanë ndodhur, është e tillë që shkon 4110 lekë. Kjo pagë, indeksohet sot me një koeficient 8.59. Pra ajo pagë mësuesi që ka qenë 7 mijë lekë të vjetra, po ta aktualizojmë sot del 360 mijë lekë të vjetra. Edhe ky indeks ➔

### KRITERET

- Mbi moshën dhe gjendjen e një personi janë përcaktuar e vlerësuar dhe kriteret e marrjes së pensionit të pleqërisë, bazuar në ligjin 7703.
- Ligji 7703 nënkupton trajtimin me përfitime afatgjata të grupeve të interesit, të cilët është mirë që të kenë sa më shumë vite pune me kontribute.
- Për të përfituar pension duhet që kandidati të ketë jo më pak se 15 vite punë si për gratë dhe për burrat.
- Pensioni i pleqërisë merret kur burri kalon moshën 65 vjeç.
- Pensioni i pleqërisë merret kur gruaja mbush moshën 60 vjeç e 8 muaj për vitin 2018-të. Por mosha e daljes në pension për gratë është fleksibël, pasi në 2019-ën, mosha e daljes në pension për gratë do të jetë 60 vjeç e 10 muaj.

### PËRLLOGARITJA

#### Pensioni social, në varësi të viteve të punës *(shembull)*

Një grua që ka mbushur moshën 60 vjeç e 8 muaj, merr një pension pleqërie, por mund ta marrë të plotë ose të pjesshëm, në raport me vitet e punës që ka kryer. Nëse kjo grua ka 36 vjet e 4 muaj punë, e merr pensionin e plotë, e nëse ka më pak, (minimumi duhet të jetë 15 vjet) e merr pensionin për sa vite punë që ka. Nëse ka 15 vite punë, atëherë 15 do të pjesëtohet me 36.4 e ky koeficient që del, rreth 40-42% është koeficienti i atij pensioni që do të gëzojë individi. Në rastet kur një njeri ka 40 vite pune, ne pjesëtojmë 40-ën me 36.4 e si rezultat del një koeficient 1.1 i cili fillimisht korrigjon pensionin social, pra ky individ që ka 4 vite pune më shumë merr 10% më shumë nga masa e pensionit social, falë viteve të punës. Pra nga 7 mijë lekë, ky individ do të marrë 7700 lekë pension social. Shuma e viteve të punës ka influenca edhe në masën e pensionit të pleqërisë së përllogaritur sipas formulës.



sot është i përshkallëzuar, e fillojnë nga 94' deri në momentin që del në pension. Viti 2018 nuk ka indeks, kurse viti 2014, 2015 kanë koeficientët respektivë.

**Po në rastet kur individi ka punuar me paga të ndryshme, si bëhet përllogaritja?**

Pasi bëhet indeksimi, formula sesi llogaritet baza e vlerësuar mesatare është formula e bazës mesatare të vlerësuar të ponderuar, pra merren pagat për periudhën deri në vitin 1994, llogaritet një pagë e kjo ponderohet me vitet e punës. Individi edhe mund të ketë ndryshuar pozicion pune që ka pasur rrogë më të lartë, por edhe kjo indeksohet e del vlerë më e lartë. Në këto kushte gjithë periudha ponderohet, e individit i del një pagë mesatare bazë e vlerësueshme, e cila shumëzohet me 40%, në rastet kur ka punuar 40 vite (1% për çdo vit pune). Pas kësaj del një vlerë së cilës i shtojmë edhe pensionin social dhe marrim vlerën përfundimtare të pensionit të pleqërisë. Nëse baza mesatare e vlerësuar del në vlerë më të madhe, po ashtu do të rezultojë edhe pensioni. Kjo është mënyra më e thjeshtë për llogaritjen e pensionit.

"Formula e përllogaritjes së pensionit të pleqërisë është: pension social (bazë) plus një shtesë që është 1% për çdo vit sigurimi, për çdo vit punë, të bazës mesatare të vlerësuar për të gjithë periudhën që individi ka paguar kontributet."

**Cili është dokumentacioni që nevojitet për të përfituar pension pleqërie?**

Individi që mendon se mund të përfitojë pension pleqërie duhet të bazohet te kriteret, mosha dhe vitet me kontribute. Domosdoshmërish duhet të ketë dokumentin që vërteton moshën, e cila duhet të jetë mbi 60 vjeç e 8 muaj për gratë e mbi 65 për burrat. Tashmë është më e thjeshtë për ta verifikuar vërtetësinë e moshës, pasi vetë ISSH ka akese mbi regjistrin themeltar të shtetasve. Megjithatë, qytetari duhet të dorëzojë një fotokopje të kartës së identitetit, e në rastet kur pretendon të marrë kompensime të tjera që i bashkëngjiten pensionit, duhet të dorëzojë edhe dokumente të tjera si certifikata familjare për të verifikuar pjesëtarët e familjes. Kur individi mendon se ka 40 vite punë, duhet të paraqesë librezën e punës dhe dokumentin që vërteton pagat që ka marrë nga 1 janari i 1994 e deri më sot.

"Kur individi humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepen të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar."

## KOEFICIENTËT E INDEKSIMIT TË PAGAVE

| | |
|---|---|
| ➲ Për pagat referuese, deri më 1.1.1994 | 8.59 |
| ➲ Për pagat e vitit 1994 | 8.59 |
| ➲ Për pagat e vitit 1995 | 6.92 |
| ➲ Për pagat e vitit 1996 | 5.37 |
| ➲ Për pagat e vitit 1997 | 5.37 |
| ➲ Për pagat e vitit 1998 | 4.48 |
| ➲ Për pagat e vitit 1999 | 3.64 |
| ➲ Për pagat e vitit 2000 | 3.31 |
| ➲ Për pagat e vitit 2001 | 2.83 |
| ➲ Për pagat e vitit 2002 | 2.62 |
| ➲ Për pagat e vitit 2003 | 2.34 |
| ➲ Për pagat e vitit 2004 | 2.13 |
| ➲ Për pagat e vitit 2005 | 1.93 |
| ➲ Për pagat e vitit 2006 | 1.76 |
| ➲ Për pagat e vitit 2007 | 1.67 |
| ➲ Për pagat e vitit 2008 | 1.48 |
| ➲ Për pagat e vitit 2009 | 1.36 |
| ➲ Për pagat e vitit 2010 | 1.30 |
| ➲ Për pagat e vitit 2011 | 1.25 |
| ➲ Për pagat e vitit 2012 | 1.20 |
| ➲ Për pagat e vitit 2013 | 1.16 |
| ➲ Për pagat e vitit 2014 | 1.00 |

**A mund ta shpjegoni më specifikisht ku qëndron ndryshimi mes periudhës nga vitet para 1 janarit të 94'-ës dhe pas kësaj date?**

Për të gjithë ata që kanë punuar pas 1 janarit të vitit 1994 e deri më sot, listpagesat janë grumbulluar në arkivin e sistemit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore që funksionon edhe sot. Ndërsa për periudhat kur individi ka punuar para vitit 1994, shërben libreza e punës dhe nuk është e nevojshme të sjellë vërtetime page.

"Koeficientët e indeksimit janë ata koeficientë që kërkojnë që pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, ta aktualizojnë e ta sjellin në nivelin e vlerës së pagës sot, pra t'i heqin efektin "gërryes" të inflacionit."

**Si veprohet në rastet kur libreza e punës humbet?**

Kur individi humb librezën e punës, ai duhet të paraqitet pranë ISSH-së, madje edhe në rastet që ende vazhdon të punojë me kontribute. Në këtë rast, personi bën një kërkesë deklarative në të cilën jepen të dhënat individuale të personit, paraqitet historiku i të gjitha punëve që ka bërë i siguruar. Dhe pas kësaj duhet të shpjegojë që vetë personi të fjalë kërkon të pajiset me një dokument të ri ku të konfirmohen të gjitha vitet e punës që individi ka kryer. Organet e sigurimeve shoqërore, janë të detyruara ta marrin kërkesën deklarative dhe të vënë në dijeni qytetarin që duhet të presë jo më shumë se 60 ditë, derisa të bëhen të gjitha verifikimet e nevojshme mbi të gjitha punët që ka bërë personi.

**Cila është zgjidhja kur verifikimi nuk mund të kryhet pasi ndërmarrjet ku ka punuar personi mund të kenë humbur dokumentet?**

Qytetarët përgjithësisht nuk duhet të shqetësohen! Rastet që përbëjnë pak problem janë kur individi ka punuar në ndërmarrje ku dokumentet janë djegur si Kombinati "Josif Pashko", miniera e Valiasit etj. që nuk kanë regjistra themeltarë. Në këtë moment, kur nuk ka mundësi për t'u zgjidhur problemi në mënyrë administrative, qytetari duhet të drejtohet në gjykatë. Merr një vërtetim negativ pranë ISSH-së që mungojnë dokumentet dhe mbledh gjithë provat, përfshirë këtu edhe dëshmitarët. Gjykata është i vetmi organ që konfirmon dhe vërteton kohën dhe të qenit apo jo në marrëdhënie pune.

**Në cilat raste dokumentacioni mund të vlerësohet si i pasaktë?**

Dokumenti, pra libreza e punës mund të vlerësohet si e pasaktë në ato raste kur ka ndërhyrje, falsifikim datash, korrigjime vulash apo dublikatë libreze. Në momentin kur ka dublikatë të librezës së punës me siguri ka një "ngërç" e menjëherë duhet të verifikojnë regjistrat themeltarë, borderotë, apo listpagesat që të vërtetojnë faktin që individi ka qenë realisht në marrëdhënie pune.

**Cilat janë disa nga problemet që shqetësojnë më së shumti pensionistët? A janë ata të kënaqur me masën e pagesës që marrin?**

Natyrisht që ankesa ka! Dhe këto ankesa ndahen në disa kategori si ankesa për mungesën e dokumentacionit si dhe ankesa për mënyrën teknike të llogaritjes së pensionit. Mendoj që inspektorët janë specialistë, por mund të ketë edhe ndonjë gabim në hedhjen e pagave. Ka dhe një grup tjetër qytetarësh që ankohen për masën e vogël të pensionit, e ka shumë kërkesa të tilla. Duhet shpjeguar individit në mënyrë të detajuar dhe sa më saktë mënyrën e llogaritjes. Masa e pensionit sot në Shqipëri, është e vogël dhe politika e di këtë. Por dhe kontributet që janë derdhur janë në nivel minimal, në paga minimale. Një pension minimal shkon rreth 9 mijë lekë të reja në muaj.



Foto ilustruese

SIGURIMI VULLNETAR

## Goci: Mekanizëm për të ndihmuar qytetarin

Qytetarët mund të bëjnë edhe sigurim vullnetar. Nëse individi ka mundësi financiare nuk paguan kontribute për pagën 24 mijë lekë, që është edhe paga minimale sot, por paguan për një pagë dy apo tre herë më të madhe, në mënyrë që të influencohet mbi llogaritjen e bazës së vlerësuar mesatare. Kjo skemë vullnetare është e lejueshme dhe për të gjitha ato vite që nuk janë plotësuar për arsye të ndryshme. Individi para se të mbushë moshën për pension, duhet të shohë edhe këto anë, e të plotësojë gjithë periudhat që nuk ka kontribute të derdhura. Këto vite mund të paguhen vullnetarisht me pagë minimale, apo dhe shumëfishat e saj. Ky është një mekanizëm për t'i ardhur në ndihmë qytetarit.

Sigurohen votat, ja data kur do zhvillohet seanca e marrëveshjes

# Vetëvendosje e palëkundur, kundër votës për demarkacion

## *Haradinaj e konfirmon: Kemi mundësinë e korrigjimit*

Pas tri dështimeve të njëpasnjëshme për ta ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit mes Kosovës dhe Malit të Zi, koalicioni qeverisës më në fund ka arritur që t'i sigurojë votat e mjaftueshme për ta kaluar këtë marrëveshje, raporton "Zeri.info". Me këtë rast, vazhdimi i seancës për marrëveshjen për shënimin e kufirit me Malin e Zi pritet të mbahet të mërkurën e kësaj jave. Kështu bëjnë të ditura burime të sigurta të Zeri.info brenda koalicionit qeverisës, të cilat thonë se gjasat më të mëdha janë të mërkurën, porse një gjë e tillë, sipas tyre, mund të shtyhet për një ose dy ditë më së largu. "Seanca do të mbahet, votat janë siguruar, gjasat janë që demarkacioni të përmbyllet të mërkurën",- ka thënë ky burim. Seanca për demarkacionin kishte dështuar më datat 22, 23 dhe 28 shkurt. Nga ana tjetër, Lëvizja Vetëvendosje nuk ka ndryshuar qëndrim ndaj marrëveshjes për shënimin e kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. Ky fakt është bërë i ditur nga deputeti i VV-së, njëherësh sekretar organizativ i partisë, Ismajl Kurteshi. Ky i fundit pohoi për "Epoka e re" se Vetëvendosje është kundër izolimit të Kosovës, por nuk mund ta votojë versionin aktual të Demarkacionit. Sipas tij, përgjegjësit e këtij izolimi duhet të gjejnë rrugën për të dalë nga kjo situatë. Kurteshi ka vlerësuar se populli po paguan faturat e politikanëve të korruptuar. Mes të tjerash ai u shpreh i pakënaqur me mënyrën e qeverisjes në vend dhe, sipas tij, qeveria aktuale është duke humbur legjitimitetin dhe besimin qytetar. Ndërkaq ka qenë kryeministri Ramush Haradinaj, i cili tha se seanca për demarkacionin do të mbahet të martën e javës së ardhshme në orën 14:00. Por ai nuk e ka qartësuar nëse kanë arritur ose jo t'i sigurojnë votat. "Të martën në ora 14:00 do të shkojmë në seancë për demarkacionin". "Edhe për mua nuk ka qenë një proces i lehtë dhe nuk është një proces i lehtë, por nuk mundem të vazhdoj më pa popullin tim të bllokuar e izoluar siç po ndodh deri tani". "Por duhet pasur parasysh që kemi ruajtur tërësinë territoriale me mundësinë e korrigjimit në drejtim të Çakorrit dhe Kullës". "Seanca është të martën në orën 14:00 dhe do ta shohim bashkë".


Kuvendi i Maqedonisë

**RAMUSH HARADINAJ**
"Të martën në ora 14:00 do të shkojmë në seancë për demarkacionin. Edhe për mua nuk ka qenë një proces i lehtë dhe nuk është një proces i lehtë, por nuk mundem të vazhdoj të shoh popullin tim të bllokuar e izoluar siç po ndodh deri tani. Por duhet pasur parasysh që kemi ruajtur tërësinë territoriale me mundësinë e korrigjimit në drejtim të Çakorrit dhe Kullës.

### Zyrtari i lartë amerikan: SHBA, pro krijimit të ushtrisë

## Qeveria kosovare në këtë fundprilli planifikon formimin e ushtrisë, ende s'e di mënyrën


Foto ilustruese

| Fier | Tetem Hysenaj | 671,240 |
| Fier | Shaqir Shehaj | 4,512,958 |
| Fier | Mestan Resulaj | EZAURUAR |
| Korçë | Agim Meka | EZAURUAR |
| Durrës | Xhemal Tila | 1,627,700 |
| Shkodër | Shuki Mani | - |
| Shkodër | Bahri Dibra | 3,319,290 |
| Shkodër | Asllan Sala | 4,604,451 |
| Shkodër | Daut Kruja | 1,097,919 |
| Shkodër | Nuro Mani | |
| Tiranë | GENC DINGA | 6,156,600 |
| Durrës | Rifat Dizdari | |
| Vlorë | Subi Goxhi | - |
| Vlorë | Gani Goxhi | - |
| Vlorë | Ziso Lokoshi | 243,000 |
| Vlorë | Krsito Dhima | EZAURUAR |
| Durrës | Xhelal Rexha | |
| Durrës | Nadire Mullaliu | 6,550,170 |
| Durrës | Hamit Mançi | |
| Fier | Neim Murati | |
| Durrës | Petrit Kurshumi | |
| Durrës | Petrit Kurshumi | 2,935,272 |
| Durrës | Franko Tufa | EZAURUAR |
| Durrës | Idriz Keja | |
| Durrës | Nikolla Shtika | |
| Durrës | | |
| Durrës | Genci Bardulla | |
| Fier | Tafil Bregu | EZAURUAR |
| Fier | Fitim Feleqi | |
| Fier | Kujtim Ngjeqari | 3,558,935 |
| Fier | Hajdar Verteniku | |
| Fier | Bukuroshe Verteniku | |
| Korçë | Ferit Nake | 491,500 |
| Korçë | Athina Nakolli | 365,840 |
| Korçë | Xhevdet Bashllari | 337,760 |
| Korçë | | |
| Korçë | Sotiraq Dushi | 7,052,760 |
| Korçë | | 500,000 |
| Korçë | Nikollaq Fundo | - |
| Lezhë | Gjin Mark Doda | |
| Tiranë | SULEJMAN RAMAZAN SAMI MERHORI | |
| Tiranë | ELEONORA VULLKANI | 2,632,000 |
| Tiranë | BAKI ABAZI | 1,665,175 |
| Tiranë | BASHKIM TOSKA | 23,372,181 |
| Tiranë | MILTIADH LASKU | 4,038,231 |
| Tiranë | SHERIF NUSHI | 15,501,211 |
| Tiranë | ISMET KOSTRECI (ZYMA) | 22,233,708 |
| Lezhë | Zef Gjoka Kasorri | |
| Durrës | Luiza Orolloga | |
| Durrës | Dhimiter Gjorga, Simon Gjorga, Vasil Gjor | 4,424,805 |
| Durrës | Jakup Hyzoti | |
| Durrës | Eleonora Tuni | 3,787,901 |

*(Vijon nesër)*

Opinioni i Ditës

# Teatër i ri: Një zgjidhje që i kënaq të gjithë…

Nga Sulejman Mato

(vijon nga faqja 1)

… dhe mendojmë për të ardhmen e artit dhe kulturës shqiptare. Ka 28 vjet që vëmendja është spostuar nga teatrot, ndërkohë që dikur, hyrja në teatro konsiderohej nga të gjithë ne si një ditë e gëzueshme, si një festë…Për të gjithë ata që nuk e dinë vlerën e teatrit, unë do t'u kujtoja tani se ne me teatro jemi rritur. Teatrot na kanë dhënë dije dhe kulturë, teatrot janë qendra të dijes, por edhe të argëtimit. Për të gjithë ata që kanë pak njohuri për rëndësinë e teatrove unë do t'u kujtoj se vetëm

> Qytetari i Tiranës nuk jeton vetëm me bukë, atij i duhet dhe kultura dhe arti, dhe kinemaja e teatri, dhe libri e filmi, dhe estrada dhe komedia, dhe opera dhe baleti, dhe muzika e lehtë dhe ajo instrumentale, dhe piktura dhe skulptura si ato të Odise Paskalit dhe Kristaq Ramës.

në Shqipëri ka ndodhur katrahura kulturore, jo vetëm në mbylljen e teatrove, të dramës dhe të humorit, jo vetëm në mbylljen e 12 Estradave që luanin një funksion të madh në argëtim dhe në edukimin shoqëror, por edhe në mbylljen e shtëpive të kulturës, shtëpive të rinisë, shtëpive të pionierit, në mbylljen e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të gjithë aktiviteteve të tjera kulturore vjetore. Le të kthehemi te çështja aq e diskutueshme: prishja e teatrit të vjetër dhe ndërtimi i një teatri të ri. Në këtë diskutim ka pasur mendime pro dhe kundër. Pro ka qenë kryeministri, artist, i cili, jo se nuk është kundër teatrit, por mendoi krijimin e një teatri të ri, në kompleksin e ndërtimeve moderne që mendohet të qëndrojë dhe ky teatër. Mendimi tjetër është restaurimi i këtij teatri. Edhe kjo ide qëndron. Madje është shumë e justifikueshme, kur mendon se në qendrën e Tiranës po i vihet kazma të gjitha ndërtesave që mund të qëndronin gati dhe si dëshmi muzeale. Midis këtyre dy versioneve, qeveria me forcën që i jep pushteti vendosi prishjen e teatrit të vjetër dhe në vend të tij krijimin e një teatri të ri, modern. Personalisht nuk jam kundër, megjithëse ende nuk e kam parë projektin. Madje edhe sikur projekti të përmirësohet, sërish nuk jam kundër ndërtimit të një teatri të ri në qendër të Tiranës, pasi, historikisht, por edhe lehtësisht, spektatori e ka më për mbarë ta ketë teatrin e vet, aty ku ka qenë, në qendër të Tiranës. Mirëpo, për t'i kënaqur të dy palët dhe artistë që kanë dhënë jetën në atë teatër, dhe të tjerët që në kushtet e kohës kërkojnë krijimin e një teatri të ri, unë do të mendoja se ekziston mundësia dhe e një version të tretë. Të lihet teatri i vjetër atje ku ka qenë, të restaurohet patjetër, por të mos preket struktura e tij, madje të funksionojë edhe në të ardhmen si i tillë, ndërkohë që teatri i ri mund të ndërtohet përkrah tij, atje ku u mendua të ekzistojë teatri i ri eksperimental, "Kujtim Spahivogli". Unë mendoj se ka arsye të mendojmë që vetëm njeri nga teatrot të ndërtohet i ri. Mund të ekzistojnë së bashku dy teatër në të njëjtin vend, ashtu siç ekzistojnë edhe tani. Duhet kuptuar se vetë shteti, pasi ndërtoi dy teatro funksionalë, në të njëjtin vend, tani vendos të prishi jo vetëm një, por dy teatro. Të gjithë e dinë që territori i teatrit është rreth 6 mijë metro katrorë, Le t'i mbeten 2 mijë metro katrorë dy teatrove, atij aktual dhe atij tjetrit, eksperimental. Kush mund ta kundërshtojë këtë ide? Përse duhet të prishen dy teatro për të krijuar një teatër, të ashtuquajtur modern? Pse të mos kemi dy teatro, pranë e pranë ashtu siç dhe i kemi? Pse teatri historik të mos mbetet dhe si një ndërtesë muzeale, duke pasqyruar në një nga sallat e tij të gjithë figurat e aktorëve tanë të shquar, të gjithë shfaqjet, historikun e saj, me rekuizitën dhe çdo gjë tjetër që i përket historisë së lavdishme të teatrit tonë popullor? Në qoftë se këtu ka synime të tjera, për ta shndërruar këtë qendër në qendër biznesi, atëherë, të gjithë ne duhet të bëhemi të ndërgjegjshëm se këtu nuk bëhet fjalë për krijimin e një teatri, por për rrëzimin historik të kulturës sonë kombëtare, me gjithë objektin e saj. E përmenda dhe pak më lart, ne sot nuk na duhet një e tre teatro. Ne na duhen shumë teatro në Tiranë dhe në rrethe. Kushdo që mendon se ka ikur koha e teatrit dhe ka ardhur koha e gratacieleve gabon. Kurrë nuk ka ikur dhe kurrë nuk do të iki koha e kulturës së një populli. Progresi i ekonomisë dhe i kulturës kanë ecur në kohëra paralelisht. Po e përsëris sërish thënien e nobelistit Ezra Paund: "Në qoftë se letërsia e një vendi pëson rënie kombi atrofizohet dhe kalbet" Nobelisti e ka fjalën vetëm dhe për gjininë e komedisë dhe dramës kombëtare, e cila sot thuajse ka vdekur, dhe brezat që vijnë nuk do të kenë më drama dhe komedi bashkëkohore, të cilat pasqyrojnë problemet kombëtare dhe ato bashkëkohore. Qytetari i Tiranës nuk jeton vetëm me bukë, atij i duhet dhe kultura dhe arti, dhe kinemaja e teatri, dhe libri e filmi, dhe estrada dhe komedia, dhe opera dhe baleti, dhe muzika e lehtë dhe ajo instrumentale, dhe piktura dhe skulptura si ato të Odise Paskalit dhe Kristaq Ramës. Nuk e di, nëse dhe Edi Rama, si i ardhur nga komuniteti i artistëve, si artist dhe bir artisti, do ta ketë këtë dëshirë, në mos për idetë e tij futuriste, së paku në shenjë homazhi për brezin e humbur të artistëve, ku bëjmë pjesë të gjithë dhe ku bën pjesë dhe i ati i tij, skulptori i nderuar dhe i shquar, miku im Kristaq Rama?



> Kush mund ta kundërshtojë këtë ide? Përse duhet të prishen dy teatro për të krijuar një teatër, të ashtuquajtur modern? Pse të mos kemi dy teatro, pranë e pranë ashtu siç dhe i kemi? Pse teatri historik të mos mbetet dhe si një ndërtesë muzeale, duke pasqyruar në një nga sallat e tij të gjithë figurat e aktorëve tanë të shquar, të gjithë shfaqjet, historikun e saj, me rekuizitën dhe çdo gjë tjetër që i përket historisë së lavdishme të teatrit tonë popullor?

Dje në "Deutsche Welle"

# 7 vite luftë në Siri dhe gabimet e perëndimit

Nga Kersten Knipp

*(vijon nga faqja 1)*



... perëndimore. Si do të kishte shkuar rrjedha e kësaj lufte, nëse perëndimi do të kishte vepruar ndryshe? Pyetja nuk është edhe aq e pavlefshme, sepse ajo lidhet me fate të panumërta, që ndoshta mund të jetonin ende, nëse perëndimi do të kishte reaguar ndryshe.

Nga pikëpamja e sotme, historia e vendimeve europiane është sidomos një histori e shanseve të humbura. Rasti më i njohur ishte në vitin 2013, kur po qartësoheshin shenjat se regjimi i Asadit kishte përdorur gaz helmues kundër popullsisë së tij, presidenti Obama bëri fjalë "për vijat e kuqe" që po kaloheshin dhe paralajmëroi për pasoja. Kur vërtet u përdor gaz helmues, Obama nuk veproi. Ai e injoroi gazin apo paralajmërimet e tij, apo të dyja së bashku.

**OBAMA DHE "VIJAT E KUQE"**

Me këtë u fshi edhe mundësia e fundit për t'i treguar kufijtë regjimit të Asadit. Ende ai nuk ishte plotësisht nën mburojën e Iranit dhe Rusisë, të paktën jo në atë masë, si aktualisht. Ende të paktën ekzistonte një drejtpeshim forcash, që e bënte të përfytyrueshëm një intervenim të SHBA dhe partnerëve të tij. Obama e humbi këtë shans. Për këtë, ai vërtet ka pasur arsye të forta. Intervenimi amerikan në Irak, një dekadë më pas në atë kohë - kishte dalë si një katastrofë politike, morale dhe propagandistike. Intervenimi i pamenduar, mbi bazën e gënjeshtrave të padurueshme i bëri SHBA-të të dukeshin një fuqi neo-imperiale arrogante - një imazh, nga i cili SHBA as sot nuk është shëruar. Nga këto arsye një intervenim i ri në Siri mbante rrezigje.

Por po kaq peshonte edhe rreziku strategjik. Në fund të fundit nuk ishte mundur të parashikohej se si do të ishte fundi i këtij misioni. Do të ishte dorëzuar Asadi? Do ta kishin pranuar Rusia dhe Irani këtë marshim në Siri? Do të kishte ngritur Obama pjesë të botës islame kundër vendit të tij? Shiitët, por ndoshta edhe sunitët? Do të thoshte ky intervenim edhe atentate të tjera terroriste në SHBA apo Europë?

**ÇMIMI I PASIVITETIT**

Nuk ka dyshim që një ndërhyrje amerikane mund të kishte pasur pasoja fatale. Dilema është se po, kjo vlen edhe për vendimin që të mos ndërhyhet. Situata e sotme është e njohur: Rusia dhe Irani kanë marrë frenat në dorë në Siri e janë kaq shumë brenda vendit, saqë një intervenim i perëndimit është i pamundur. Kërkesat e Uashingtonit dhe kryeqyteteve europiane se Asadi duhet të largohet janë bërë fjalë boshe dhe të parëndësishme. Nuk luan më rol, se çfarë dëshiron perëndimi. As gjestet e tronditjes nuk prekin më askënd. Më shumë se kaq: që SHBA që para fillimit të luftës kishin luajtur me strategji të ndryshme për rrëzimin e Asadit, strategji që me gjasë mund ta kishin zhytur po ashtu vendin në kaos, kjo i nxjerr ato si një vend me qëllime të dyshimta.

Gjërat nuk u zhvilluan më mirë, kur presidenti Obama dhe partnerët e tij në vend të një ndërhyrjeje të ashpër, zgjodhën politikën e pavendosmërisë. Mbështetje e rebelëve po, por jo shumë nga frika se mbështeten të gabuarit (xhihadistët). As kjo strategji nuk e përmirësoi gjendjen, përkundrazi ajo inkurajoi opozitarë të panumërt në një luftë, që nga pikëpamja e sotme ishte humbur që atëherë. Jo vetëm ata u vranë. Edhe qindra mijëra civilë u bënë viktima të dhunës së papërfytyrueshme.

**FJALË GOJE? KURRË MË!**

Çështja është çfarë mund të mësohet nga kjo? Intervenimet e perëndimit janë bërë në mënyrë diletante dhe dështuan përgjakshëm si në Irak edhe në Libi. Është e qartë që perëndimi në plan afatgjatë nuk është më në gjendje për operacione të tilla. Por ai nuk mund t'ua lërë edhe fushëbetejën të tjerëve. Kthesa që Rusia dhe Irani sollën në luftën e Sirisë mban cinizëm të pashoq. Për të ardhmen, për Sirinë është shumë vonë, mund të thuhet vetëm "ujditë e mundshme duhet të ndiqen pas nga veprime të vendosura". Ose perëndimi të mbajë duart larg që në fillim. Asgjë nuk arrihet me fjalë goje. Ato vetëm e përkeqësojnë gjendjen.

BalkanWeb.com
AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.
MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE
MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE
DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

## HOROSKOPI

### DASHI

Në vend që të ankoheni për faktin se koha juaj është plotësisht e zënë nga puna dhe angazhimet, provoni të organizoni më mirë ditën tuaj! Nëse menaxhoni si duhet angazhimet tuaja, do arrini të gjeni hapësirë për t'ju përkushtuar vetes.

### DEMI

Ditë ideale për bashkëpunime të reja fitimprurëse. Jeni gati për të vepruar në favor të personave që kanë nevojë për eksperiencën tuaj. Pika e fortë është aftësia juaj për të lidhur logjikën me intuitën, duke vlerësuar situatën nga të dyja perspektivat.

### BINJAKET

Lart në qiell, çifti Hëna-Neptun ka fuqinë t'ju ngatërrojë. Emocionet që sot ju duken të rëndësishme, do harrohen pa lënë gjurmë shumë shpejt. Si gjithmonë do fokusoheni tek projektet tuaja në punë, ka ardhur momenti të shihni rezultatet e para.

### GAFORJA

Ditë e shkëlqyer ku do të mbizotërojë humori i mirë, megjithëse me tipat si ju asnjëherë nuk dihet si mund të përfundojë! Hëna dhe Neptuni ju dhurojnë intuita të shkëlqyera, të cilave duhet të dini t'ju jepni peshën e duhur.

### LUANI

Me çiftin Hëna-Neptun në shtëpinë e tetë misterioze dhe sekrete, sot keni shumë pak dëshirë të komunikoni dhe të rrini me të tjerët. E premte pa shumë ngjyra, pa ndonjë emocion ose kënaqësi në aspektin profesional.

### VIRGJERESHA

Gënjeshtrat dhe gjysmë të vërtetat ju acarojnë më shumë se çdo gjë. Edhe ju keni defektet tuaja, por sinqeriteti është gjithmonë në vend të parë mes idealeve tuaja! Keni dyshimet tuaja për një bashkëbisedues që premton mrekullia: ku i dihet ndoshta nuk janë vetëm fjalë.

### PESHORJA

Gjithmonë keni shumë gjëra për të bërë, në zyrë, shtëpi ose jashtë, duke u angazhuar në mënyrë vullnetare kundër çdo lloj padrejtësie. Krijimtaria dhe nevoja për të realizuar projektet tuaja mund të shprehen edhe përmes aktiviteteve të tjera jashtë punës.

### AKREPI

Jeni në humor të mirë falë mbështetjes së duhur të Hënës që arrin në mënyrë të mrekullueshme t'ju dhurojë optimizëm dhe besim. Gjeni kohë për miqtë e afërt. Aventura të reja në horizont.

### SHIGJETARI

Mos u fshihni pas justifikimeve të kota: nëse nuk keni dëshirë të kaloni kohën tuaj me persona të caktuar, më mirë shprehuni qartë. Gjeni pak hapësirë për gjërat që me të vërtetë ju interesojnë, do merrni nxitjen e duhur për të shijuar ditën.

### BRICJAPI

Të kujdesshëm si gjithmonë, do jeni të qetë vetëm kur të siguroheni që nuk keni lënë asgjë pezull. Nuk ka zgjidhje tjetër: në fillim puna, pastaj kënaqësia. Nëse keni plan të blini shtëpinë tuaj të parë, vlerësoni mirë avantazhet dhe disavantazhet e një oferte.

### UJORI

Duhet të mendoni për dashurinë, sado që ju duket sfiduese dhe e trazuar: për momentin ju intereson të mbani limitet e një miqësie të mirë dhe të relaksuar. Nga një udhëtim biznesi do ktheheni të lodhur, por të kënaqur: edhe këtë herë keni arritur objektivin tuaj!

### PESHQIT

Ditë pozitive në shumë aspekte në lidhje me efikasitetin dhe frymëzimin për projektet e ardhshme. Në dashuri mjafton vetëm një fjalë, një shikim, një shenjë për të shprehur ndjeshmërinë tuaj të thellë dhe intensive.




## Guri do të jetë ndaj Vllaznisë

# Gjici shmang 'furtunën' në mbledhjen e Kukësit

Humbja e pësuar në Gjirokastër ka lënë pa fjalë presidentin e kampionëve të Shqipërisë. Safet Gjici sheh nga java në javë t'i tretet ëndrra për të mbrojtur kurorën e kampionit, e cila duket se është e destinuar që të udhëtojë drejt Korçës. Tashmë Kukësi e sheh veten në luftë për vendin e dytë e shkëputur me pak pikë nga një grup i madh ndjekësish, ku më i afërti është Laçi i vendit të tretë. Gjici e ka braktisur tribunën në stadiumin "Gjirokastra" përpara vërshëllimës së fundit, ndërsa dje ka zhvilluar një mbledhje me ekipin. Por, ndryshe nga sa kemi mësuar të ndodhë zakonisht në mbledhjet e verilindorëve në situatë të tilla, kësaj radhe çdo gjë ka kaluar pa shumë zhurmë. Analiza e ndeshjes është bërë e plotë dhe janë shmangur tonet e larta. Duket se Gjici, i vetëdijshëm për atë që mund të ndodhë në një moment të tillë, ku edhe Europa nuk është e garantuar, kërkon të shmangë presionin dhe ka lejuar të tijtë të vijojnë procesin normalisht. Ndërkohë ka pasur një "çështje" në kampin verilindor. Sidrit Guri u mendua se kishte humbur takimin e radhës ndaj Vllaznisë, por sulmuesi shkodran nuk e ka plotësuar numrin e kartonëve të verdhë, ndaj do të jetë në gatishmëri të trajnerit Pakult si edhe gjithë pjesa tjetër e ekipit.

### Me Bardhin që shpërdoron pa fund, anësori pritet të shkojë më shumë drejt portës kundërshtare

# Partizani sytë nga Asani, Jasiri shihet si pikë referimi

## *Dalipi e zëvendëson, por kursen energjitë e tij*



Jeton Selimi

Në fakt, Jasir Asani nuk mund të quhet përforcim i janarit. Ish-talenti i Vardarit dhe kontingjenti i përfaqësueses së Shqipërisë, erdhi te Partizani me kampionatin që sapo kishte filluar dhe u inkuadrua në lojë pak muaj më pas, duke dhënë menjëherë impakt e duke u kthyer në të paprekshëm në skemat e Julianos, Starovës dhe sot Dalipit. Nuk është rastësi që numri 16 i të kuqve bën pjesë në preferencat e tre trajnerëve të ndryshëm. Shpejtësi në krah, shpërthim me top në këmbë, aftësi të shkëlqyera dribluese dhe një e majtë "e hidhur" në harkimet e tij nga e djathta e sulmit apo në goditjet drejt kuadratit kundërshtar! Dalipi ka në duar një xhevahir dhe detyra e tij është që t'i japë më shumë përparësi në aksionet që ndërmerr. Kjo do të bëjë që të bjerë disi influenca e një tjetër talenti. Jurgen Bardhi shikohet nga stafi i kuq e sidomos nga drejtori Olsi Rama si një sulmues i fshehtë. I famshmi "neuve falso", element befasie që aplikohet në ekipet më në zë të planetit, por që te Partizani nuk ka arritur të ketë impaktin e dëshiruar, kjo për shkak edhe të një roli të ri që atij i kanë kërkuar të bëjë.

Gjithsesi, kthehemi tek Asani. 22-vjeçari (23 majin e ardhshëm) është një aset i çmuar i klubit të kuq. Partizani e kërkoi lojtarin edhe dy vite më parë, por asokohe Vardari nuk u tërhoq nga shifra prej 200 mijë eurosh për kartonin e tij, çka bëri që ofensiva e kuqe të sprapsej. Gjithsesi, "martesa" ishte e shkuar të bëhej, kjo sepse lojtari dëshironte me çdo kush të vinte në kryeqytet e të mbronte fanellën e Partizanit. Madje duke refuzuar dhe ofertën e Fakiçit për të shkuar te Skënderbeu, ftesën e Duros për t'iu bashkuar te Flamurtari dhe pak para firmës me Partizanin, sapo i kishte mbyllur me mirësjellje telefonatën Kukësit. Te Partizani e dinë shumë mirë se çfarë është në gjendje të bëjë lojtari, por njëkohësisht edhe zëvendësimet e shpeshta shpesh e kanë mërzitur atë. Sidomos kur numri i shënuar në tabelën elektronike ndërrohet papritur si në ndeshjen ndaj Vllaznisë, Teutës, apo Luftëtarit... Gjithsesi, Asani e di mjaft mirë atë që duhet të bëjë. Djaloshi respekton fanellën, tifozët dhe klubin ndaj shumë shpejt mund të marrë vëmendjen e duhur, qoftë në fushë qoftë jashtë saj, duke zhbalancuar në këtë formë hierarkitë në ekip, për ta çuar sulmin e kuq gjithnjë e më shumë në finalizimin e aksioneve.




### SKËNDERBEU



## Muzaka kthehet në stërvitje, FSHF e çon Liçon te Legenasi

Skuadra e Skënderbeut nuk ka bërë asnjë ditë pushimi pas ndeshjes së barazuar dje ndaj Teutës. Edhe pse korçarët janë të qetë në rrugëtimin drejt titullit kampion dhe kanë luksin të bëjnë disa javë pushim dhe të jenë përsëri në krye falë shkëputjes që kanë krijuar nga ndjekësit, trajneri Daja nuk do që të tijtë të ulin sadopak ritmin. Për këtë arsye, skuadra dje ka filluar përgatitjet në Korçë, ku është grumbulluar për ndeshjen e radhës, në të cilën pret një ekip shumë interesant si Luftëtari. Në stërvitje me korçarët është kthyer edhe Gjergji Muzaka, një futbollist i cili është kthyer në thelbësor për mesfushën e kësaj skuadre. Këtë e pranoi edhe vetë trajneri Daja pas ndeshjes së djeshme, ku bëri të qartë se mungesa e Muzakës kishte ndikuar në lojën e skuadrës. Në stërvitje me ekipin ishte si zakonisht edhe mesfushori i talentuar Dean Liço. Djaloshi pritet që së shpejti të kalojë në kampionatin spanjoll, ku ka nja akord parimor me ekipin e Leganes. Edhe pse marrëveshja nuk është finalizuar dhe lojtari vazhdon të jetë 100% pjesë e Skënderbeut, në FSHF e kanë bërë fakt të kryer një transferim të tillë. Liço figuron i grumbulluar nga U-19 e Erjon Bogdanit për miqësoret ndaj Kazakistanit, ndërsa Sektori i Ekipeve Kombëtare në FSHF e ka rreshtuar atë në listë si futbollist të ekipit spanjoll.

### KOMBËTARJA

## Panuçi i "rrëmben" Ramadanin, Bushi ndryshon mesfushën

Shpresat do të luajnë në një moment mjaft delikat kundër Sllovakisë, pasi matematika e lejon ende ëndrrën e kuqezinjve për ta mbyllur grupin kualifikues të Europianit 2019 në vendin e dytë. Por teksa kuqezinjtë e vegjël do të kërkojnë të përmbushin një mision mjaft të vështirë, Alban Bushi duhet t'i bëjë llogaritë e tij pa një tjetër futbollist kryesor. Ylber Ramadani nuk do të jetë pjesë e këtij ekipi, pasi Panuçi e ka grumbulluar mesfushorin për ndeshjen ndaj Norvegjisë. Mesfushori 21-vjeçar do të jetë pjesë e projektit të teknikut italian në vazhdimësi, përtej ndeshjes miqësore që do të zhvillohet ndaj Norvegjisë.



### KUQEZINJTË

## Shqipëria dhe Kosova fitojnë nga 1 vend në renditjen e FIFA-s

Ditën e djeshme është publikuar renditja e re nga FIFA, sa u përket Kombëtareve. Kështu, Shqipëria dhe Kosova kanë ngjitje në këtë renditje, pasi kanë përmirësuar nga një pozicion. Kombëtarja shqiptare renditet në vendin e 58-të, nga vendi i 59-të në të cilin renditej më parë. Pavarësisht se Kombëtarja nuk ka zhvilluar një ndeshje në këtë periudhë, në këtë përmirësim kanë ndikuar ndeshjet e Kombëtareve të tjera që renditeshin lartë Shqipërisë. Nga ana tjetër, një përmirësim ka edhe Kosova, që tashmë renditet në vendin e 176-të.

Ndërkohë, federata greke do të ndëshkojë PAOK-un. Rrezikon rënien një kategori më poshtë

# Ajdareviç: Greqia është bërë si "Perëndimi i egër"

## Mesfushori: Klubet kanë gjyqtarët e tyre

Jeton Selimi



Ngjarjet që kanë ndodhur së fundmi në Greqi kanë tronditur mesfushorin e përfaqësueses shqiptare, Astrit Ajdareviç, i cili ka parë se si një sezon thuajse perfekt me AEK po mbyllet në kaos pas ngjarjeve që ndodhën me presidentin e PAOK, i cili hyri në fushë i armatosur. "Skuadra jonë nuk ka fituar titullin prej 24 vitesh dhe tani të gjitha ndeshjet janë ndalur pa afat. Ne kemi pasur një sezon fantastik deri tani dhe na ndodhi kjo gjë. Nëse nuk do të fitonim tani titullin, do të ishte e tmerrshme. Jemi të gjithë të tronditur. Njëkohësisht mund të them se çfarë kam përjetuar për dy vite këtu, nuk e kam përjetuar gjatë të gjithë karrierës time futbollistike", tregoi ai për mediat suedeze. I pyetur rreth saj që pret tani për të ardhmen e AEK-ut dhe futbollit grek, mesfushori nuk ka ditur të japë përgjigjje. "Nuk di të them. Këtu flitet rreth faktit se klubet kanë arbitrat e tyre, disa kanë njerëz brenda federatës që i mbajnë pranë. Ka kaq shumë pushtet dhe para të përfshira këtu. Këtu është, siç tha trajneri ynë, Manuel Himenez, plotësisht si 'Perëndimi i Egër'. Ndoshta UEFA dhe FIFA duhet të ndërhyjnë, duhet që të vijnë gjyqtarë nga jashtë", tregoi mesfushori shqiptar.

**GATI DËNIMI**

58-vjeçari hyri në fushë kur skuadrës së tij iu anulua një gol në ndeshjen kundër AEK-ut të Athinës në minutën e 89, duke shkaktuar pushtim të fushës dhe si pasojë ndeshja u braktis. Konstantinos Simitzoklou, pjesëtar i Federatës Greke të Futbollit, thotë se ajo që ndodhi do t'i ngarkohet Neni 19 i rregullores dhe skuadra mund të rrëzohet në një kategori më poshtë për shkak të kërcënimeve të zyrtarëve të ndeshjes. Një dënim tjetër i rëndë, por që në këtë rast është i lehtë krahasuar me atë që ka ndodhur, do të jetë zbritja e disa pikëve dhe një gjobë e majme për këtë ekip. Ivan Savidis, biznesmeni grekorus që është dhe mik i Vladimir Putin rrezikon të paktën 3 deri në 5 vite pezullim nga aktivitetet sportive për shkak të kërcënimit të zyrtarëve të ndeshjes. Qeveria greke ka ftuar në Greqi zyrtarët e FIFA-s dhe UEFA-s që të diskutojnë për këtë ndeshje. Ndërhyrja shokuese e Savvidis ka detyruar që kampionati elitar grek të pezullohet, ndërsa këtë gjë e konfirmoi ministri i Sporteve, Jorgos Vasiliadis të hënën pas një komunikimi me kryeministrin Aleksis Cipras. Duke u bazuar te deklarata e publikuar në sajtin zyrtar të PAOK-ut, ish-pjesëtari i parlamentit rus deklaroi se ai nuk ka kërcënuar askënd. PAOK, i cili është në vendin e tretë të tabelës pas Olimpakiosit dhe AEK-ut është përfshirë në një tjetër akt dhune në muajin e fundit. Trajneri i Olimpiakosit, Oskar Garsia, u qëllua nga fansat e PAOK-ut me një letër tualeti dhe bëri që ndeshja të pezullohej.

### Por i ka realizuar në 14 ndeshje më pak

## Mesi barazon rekordin e Ronaldos, shënon 100 gola në Champions



Kristiano Ronaldo është golashënuesi më i mirë në historinë e Ligës së Kampioneve me 117 gola të realizuar, por Lionel Mesi vazhdon të thyejë rekorde që portugezi ka vendosur para tij. Futbollisti argjentinas shënoi dy herë mbrëmë përballë Çelsit, duke kaluar në të dyja rastet topin mes këmbëve të Kurtua, për të arritur shifrën 100 në Europë dhe për të thyer një rekord të vendosur nga portugezi dy vite më parë. Mesit iu deshën 123 ndeshje për të arritur në kuotën e 100 golave në këtë turne, 14 më pak se Ronaldo, i cili kaloi te treshifrori vetëm në ndeshjen e tij të 137. "Është një kënaqësi të shënosh 100 gola në këtë turne kaq të bukur. Ndeshja ishte në favorin tonë shumë shpejt dhe ishim në gjendje të menaxhonim mirë situatën. Ishim të fortë dhe të përqendruar për të 90 minutat e sfidës", tha vetë argjentinasi pas këtij dueli, ku ai regjistroi një rekord personal. Goli i shënuar mbrëmë, pas vetëm 2 minutash e 8 sekondash lojë, ishte më i shpejti që ka shënuar në karrierën e tij. Më parë rekordi i tij personal për gol të shpejtë ishte ai i shënuar me fanellën e Argjentinës ndaj Nigerisë në Botërorin 2014, kur gjeti rrjetën pas 2 minutash e 26 sekondash lojë.

FLET LEGJENDA



### Pele: Ja cili është lojtari më i mirë në botë

Legjenda e futbollit brazilian, Edson Arantes do Nashimento, i njohur shkurt me emrin Pelé, deklaroi se Lionel Mesi, Kristiano Ronaldo dhe Nejmar janë lojtarët më të mirë në botë për momentin. "Meqë jam një njeri me tri zemra, do të qëndroj te Mesi, Ronaldo dhe Nejmar. Më i miri i të gjithë kohërave? Atëherë do të them Pele", u shpreh mes të qeshurave 77-vjeçari, duke shtuar më tej se 1283 golat që ka shënuar gjatë karrierës së tij e bëjnë të pakrahasueshëm me të tjerët. 100 ditë para nisjes së Kupës së Botës, "Rusi 2018", Pelesë iu kërkuar një mendim për skuadrën favorite. "Do të organizoj një festë nëse Brazili shpallet kampion për herë të gjashtë në historí. E vetmja gjë që nuk mund të premtoj, - vijoi me humor Pele, - është pjesëmarrja ime në Rusi. Kanë mbetur vetëm 3 muaj...". Pele shpjegoi më tej se ka menduar të bëhej futbollist që në moshën 3-4-vjeçare, sepse dëshironte t'i ngjante babait. "Ishte ëndrra ime dhe Zoti më ndihmoi shumë për gjithçka i kam dhënë futbollit". Pele ka arritur ta fitojë tri herë Kupën e Botës: në Suedi (1958), Kili (1962) dhe Meksikë (1970).

SERIE A

### Hamshik: Napoli do të luftojë deri në fund

Marek Hamshik nuk dorëzohet. Mesfushori sllovak beson ende te fitimi i titullit kampion, edhe pse tashmë është Juventusi skuadra që kryeson Serinë A, madje me 4 pikë më shumë se të kaltrit e Sarrit. Golashënuesi më i mirë i të gjitha kohërave te Napoli dhe njëkohësisht kapiteni i skuadrës jugore, mendon se 4 pikë kur mbeten edhe 10 javë për t'u luajtur janë të rikuperueshme, kjo edhe për faktin se Juventusi ka një kalendar më të vështirë se skuadra e Sarrit. "Ndaj Romës gjithçka shkoi keq për ne, ndërsa ndaj Interit u ndamë në një barazim 0-0. Këto dy skuadra na kanë bërë të vuajmë, por të mos harrojmë që edhe Juventusi do të përballet ndaj këtyre dy ekipeve. Ndaj Romës dhe Interit do të vuajnë edhe bardhezinjtë, jam i sigurt për këtë. Beteja për titullin kampion vazhdon dhe ne besojmë dhe do të luftojmë deri në fund. Plus që është edhe përballja direkte mes nesh dhe Juves për t'u luajtur".

HETIMI KA NISUR

### UEFA do dënojë Beshiktashin për një mace

Një ngjarje e veçantë ka ndodhur në ndeshjen mes Beshiktashit dhe Bajernit gjatë ditës së djeshme. Takimi është fituar nga ana e ekipit të Hejknes me rezultatin 1-3. Por ajo që ka tërhequr vëmendjen e mediave sportive europiane, ishte minuta e 51-të e këtij takimi. Një mace ka hyrë në fushën e lojës, duke sjellë edhe ndërprerjen e ndeshjes. Ajo është shfaqur në këndoren e fushës ku qëndronte i vendosur ekipi turk, ndërsa është dashur ndërhyrja e sigurimit për ta larguar nga fusha. Kaq ka mjaftuar që UEFA të nisë procedimin e saj kundër Beshiktashit, pasi ky rast pasqyron dështimin në organizimin e këtij takimi.



'TËRBOHEN' NË PARIS

### Babai Nejmarit takon fshehurazi Florentino Perezin

AS" në Spanjë bën të ditur lajmin se Reali i Madrid it synon ta mbyllë çështjen "Nejmar" para se të fillojë Botërori i Rusisë. Koha shtrëngon për një operacion, që komplikohet në fakt nga shumë detaje, ku kryesore është vlera e lojtarit, si dhe prestigji i dy klubeve. PSG-ja në verë pagoi 222 milionë euro për klauzolën e prishjes së kontratës së Nejmarit me Barcelonën. Tani nuk dëshiron ta shesë, por sipas shtypit spanjoll dhe atij brazilian, babai i sulmuesit, që është edhe agjenti i tij, javën që shkoi ka takuar Florentino Perezin për të studiuar një strategji, që do ta çonte te Reali i Madridit ish-lojtarin e Barcelonës. Po ashtu, gjithmonë sipas shtypit spanjoll, babai i Nejmarit mësohet se i ka thënë Perezit se në Paris Nejmar nuk ndihet mirë, që do të thotë se shtohen shanset e transferimit sërish në Spanjë. Ndërkohë, Marselo, mbrojtësi brazilian i Realit, i ka bërë të ditur Nejmarit se skuadra mezi e pret.

## Koçijançiç: KE pret që ligji të dërgohet në Komisionin e Venecias

# Ligji për shqipen, Gjorge Ivanov refuzon dekretimin

## *Miratimi i ligjit për gjuhët, VMRO do padisë Talat Xhaferrin*

Presidenti i Maqedonisë, Gjorge Ivanov e ka quajtur "antikushtetues, antishtetëror dhe nxitës të tensioneve ndëretnike", miratimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e Kuvendit të Maqedonisë. Ai ka bërë të ditur vendimin e tij për mos dekretimin e këtij ligji, të miratuar nën tensione nga shumica parlamentare. "Ligji për përdorimin e gjuhëve, në mënyrën se si është hartuar, por edhe votuar do të shkaktoj bllokadë të plotë në punën e institucioneve. Në kushte të bllokadës së institucioneve, gjasat janë të mëdha që të hapet edhe çështja e ridefinimit të rendit tonë kushtetues",- ka thënë Ivanov. "Ligji për përdorimin e gjuhëve është jo i drejtë, ligj represiv, që favorizon vetëm se një gjuhë. Një ligj i tillë do të shkaktoj tensione dhe paraqet kërcënim për bashkëjetesën ndëretnike. Si presidenti i shtetit këtë unë nuk do ta lejoj. Andaj, nuk do të nënshkruaj dekretin për shpalljen e këtij ligji të miratuar në këtë formë",-ka deklaruar presidenti Ivanov në një paraqitje drejtuar qytetarëve të Maqedonisë. Ai ka drejtuar akuza të rënda ndaj kryeministrit, Zoran Zaev dhe shumicës parlamentare për siç ka thënë, mos respektimin e garancive të dhëna se do të respektojnë Kushtetutën dhe se nuk do të miratojnë ligj antishtetërore. "Ky ligj është shprehje e tiranisë të shumicës parlamentare ndaj shumicës së qytetarëve të Maqedonisë. Shumica e qytetarëve asnjëherë nuk kanë votuar, dhe as që do të votonin një program politik që parasheh një ligj të tillë, antikushtetues, antishtetëror dhe ligj të dëmshëm. Një ligj i tillë jo i drejt nuk meriton të quhet ligj",-ka deklaruar Ivanov. Por, bazuar në nenin 75 të Kushtetutës, presidenti i shtetit është i obliguar të dekretojë ligjin, nëse i njëjti miratohet për herë të dytë nga Kuvendi. Ligjet hynë në fuqi me dekret. Dekreti për hyrjen në fuqi të ligjeve nënshkruhet nga Presidenti i Republikës dhe Kryetari i Kuvendit. Presidenti i Republikës mund të vendos të mos e dekretojë ligjin për hyrjen e tij në fuqi. Kuvendi sërish voton ligjin dhe nëse miratohet me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, Presidenti i Republikës është i obliguar ta dekretojë atë",-thuhet në nenin 75 të Kushtetutës. Ndërkaq zëdhënësja e Komisionit Evropian (KE) Maja Koçijançiç, ka folur për Pigjin për përdorimin e gjuhëve të miratuar në Parlamentin e Maqedonisë. Siç raporton korrespondenti i agjencisë AIM, nga Brukseli, Koçijançiç ka deklaruar se Komisioni Europian pret që ligji të dërgohet në Komisionin e Venecias, siç është paralajmëruar në planin 3-6-9. "Zbatimi i ligjit duhet të jetë sipas standardeve europiane", -thotë Koçijançiç. Ajo shtoi se, KE pret që Kuvendi të përqendrohet në reforma dhe që Maqedonia të ecë përpara me axhendën drejt integrimit në Bashkimin Europian. Ndërsa kreu i VMRO-DPMNE-së Hristijan Mickoski në një konferencë për media u shpreh se ai dhe subjekti i tij VMRO-DPMNE nuk do ta njohin Ligjin për përdorimin e gjuhëve. Mickoski paralajmëroi padi penale ndaj kreut të Kuvendit Talat Xhaferi për siç u shpreh shkelje të Kushtetutës dhe ligjeve. Ai theksoi se ligji vjen si rezultat i një marrëveshjeje mes LSDM-së dhe BDI-së, të cilat nuk kanë mbajtur llogari për pasojat që do të sjellë miratimi i këtij ligji. Mickoski njoftoi se partia e tij do të ngrejë iniciativë në Gjykatën Kushtetuese, rreth kushtetutshmërisë së ligjit për përdorimin e gjuhëve.



Kuvendi i Maqedonisë

**GJORGE IVANOV**

"Ligji për përdorimin e gjuhëve, në mënyrën se si është hartuar, por edhe votuar do të shkaktojë bllokadë të plotë në punën e institucioneve. Në kushte të bllokadës së institucioneve, gjasat janë të mëdha që të hapet edhe çështja e ridefinimit të rendit tonë kushtetues".

## Vuçiç: Jemi të gatshëm për kompromis, jo për poshtërim

# Mbrojtësit e Kosovës dhe Metohisë akuzojnë presidentin serb: Po e shet Kosovën për BE

Themeluesit e të ashtuquajturit "Apeli për mbrojtjen e Kosovës e Metohisë" (siç e quajnë ata Republikën e Kosovës në Beograd), përmes një komunikate theksojnë se "pas bisedës qartësisht të pakëndshme" të presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiç, me ndihmëssekretarin e Shtetit të SHBA, Wess Mitchell, "përfundimisht ka dalë në shesh inskenimi shumë mujor i autoriteteve serbe i quajtur 'dialogu i brendshëm për Kosovën'". Në këtë mënyrë, fatkeqësisht "konfirmohet frika e themeluesve të Apelit për mbrojtjen e Kosovës nga fundi i vitit të kaluar", gjë që sipas tyre e ka bërë vetë Vuçiç, duke thënë se "Pengesa më e madhe në rrugën tonë për në Bashkimin Europian është problemi i Kosovës, prandaj jemi të gatshëm për kompromis, por jo për poshtërim". Sipas interpretimeve të themeluesve të këtij Apeli, "shkak i këmbënguljes për të ashtuquajturën 'marrëveshje historike me shqiptarët' është ekskluzivisht hyrja në BE dhe jo synimi për gjoja heqjen e barrës së rëndë nga shpina e brezave të ardhshëm, siç na betohej gjithë kohën presidenti i Serbisë". "Problemi i Kosovës dëshirohet 'të zgjidhet' tani, jo pse autoritetet tona e dinë si ta zgjidhin në favor të Serbisë, por pse është të parakusht shantazhues i Brukselit dhe i Berlinit për anëtarësim eventual në Bashkimin Europian të trazuar nga kriza",-pohojnë themeluesit e Apelit. Sipas tyre "Vuçiç përpiqet ta mbyllë secilin modalitet propagandues të gjunjëzimit përfundimtar të Serbisë para shantazhit perëndimor të popullit serb" si gjoja 'kompromis'".



Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç

**ALEKSANDËR VUÇIÇ**

"Pengesa më e madhe në rrugën tonë për në Bashkimin Europian është problemi i Kosovës, prandaj jemi të gatshëm për kompromis, por jo për poshtërim", - ka thënë presidenti serb, Aleksandër Vuçiç.

## SHKURT

### Erdogan, thirrje turqve: Bëhuni gati për Luftën e Tretë Botërore

Mediat greke i kanë kushtuar rëndësi të madhe një deklarate të presidentit të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan, i cili ka paralajmëruar se bota po shkon drejt një lufte të re. "Shtetet e Bashkuara kanë ndërtuar njëzet bazat në Siri, bazë që është drejtuar kundër Rusisë dhe mund të bëhet shkak për të shpërthyer Lufta e Tretë Botërore. Pyetja është pse ata kanë nevojë për bazat amerikane në Siri"- tha Erdogan. Sipas mediave greke, i pari i Turqisë i ka kërkuar popullit të tij të përgatiten për të gjitha mundësitë. "Le të bëhemi gati për Luftën e III Botërore. Ne duhet të jemi gati për të gjitha mundësitë"- tha ai.

### SHBA, sanksione kundër 19 spiunëve ruse

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vendosur sanksione ndaj 19 rusëve, të cilët dyshohet se kanë ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2016. Ata dyshohen edhe për përfshirje në sulmet kibernetike. Një muaj më parë këshilltari i departamentit të Drejtësisë Robert Mueller, prezantoi sanksione ndaj 13 rusëve të dyshuar për përfshirje në zgjedhjet në SHBA. Sekretari i Thesarit Steven Mnuchin akuzoi rusët për "sulmet kibernetike shkatërruese dhe ndërhyrjet në zgjedhje". Ai tha se sanksionet synojnë shmangien e "ndonjë sulmi tjetër" nga Rusia. Masat e marra këtë të enjte, përfshijnë edhe shërbimet ruse të inteligjencës. Në Uashington, këto sanksione cilësohen si veprimi më i fortë i marrë deri më tani nga administrata Trump kundër Moskës.

### Arratiset princesha e Dubait, "tërbohet" sundimtari i shtetit

Princesha e Dubait, Sheikha Latifa është zhdukur pas një video të postuar në YouTube ku thotë se "kjo mund të jetë e fundit". 33-vjeçarja Latifa, e cila thuhet se është zhdukur bashkë me amerikanin Herve Jaubert, ka udhëzuar avokatin e saj të hedhë videon në internet. Princesha, e cila flet drejtpërsëdrejti në kamera, shihet me flokë të mbledhura dhe një bluzë blu. "Po e bëj këtë video se mund të jetë e fundit"-thotë ajo. "Do të largohem diku dhe nuk e di se kur mund të kthehem, por besoj se kjo do funksionojë"-është shprehur princesha. Vajza, e cila thotë se është vajza e Sheikh Muhammed bin Rashid Al Maktoum, një miliarder i vendit, thotë se ajo nuk ka lirinë për të jetuar jetën e saj në Dubai dhe u mbajt fshehurazi në burg për tre vjet pas një tentative të dështuar të arratisjes kur ishte adoleshente. Latifa fshehur në një jaht jashtë brigjeve të Indisë jugore dhe pritet të kërkojë azil politik në Shtetet e Bashkuara.

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH
www.gsh.al

Tashmë edhe lundroni!

